

Drejtësia tranzicionale në Kosovë

Punim Diskutues

Ky projekt është përkrahur nga Zyra e Komisionarit të Lartë për Pakica Kombëtare dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Suedisë, por nuk i praqet qëndrimet e këtyre institucioneve.

Përgatitur nga: Ilir Dugolli dhe Ilire Agimi

Redaktuar nga: Lulzim Peci dhe Ilir Deda

Copyright © 2009 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Përveç për mesimdhënie apo për qëllime tjera jokomerciale, asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Pjesë të shkurtra të tekstit, që nuk kalojnë dy paragrafë, mund të citohen pa lejen shprehimore të dhënë nga autori me kusht që të njihet burimi i plotë i tekstit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 227 778.



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rexhep Mala, 5A, Kati II
10000 Prishtinë, Kosovë
Telefon dhe Fax: +381 38 227 778
www.kipred.net

Përmbajtja

1. Hyrje	Error! Bookmark not defined.
2. Drejtësia tranzicionale – koncepti dhe mekanizmat kryesorë të saj	6
a) Ndjekja penale për krime ndërkombëtare	7
b) Komisionet e së vërtetës	8
c) Kujtesa dhe përkujtimi	12
f) Përvojat rajonale	12
3. Historik i konfliktit në Kosovë	14
4. Drejtësia tranzicionale në Kosovë	17
4.1. Palët kryesore të interesit dhe politikat	19
4.1.1. Palët ndërkombëtare të interesit	19
4.1.2. Palët vendore të interesit	23
4.2. Dokumentet kryesore	27
4.3. Mekanizmat e luftimit të padrejtësive dhe keqpërdoruesve	27
5. Përfundime dhe rekomandime	30

1. Hyrje

Luftërat dhe represioni shtetëror kanë lënë shoqëri të shkatërruara dhe shumë njerëz të traumatizuar, të zhvendosur apo të humbur. Një rast i tillë është edhe Kosova. Kosova sot paraqet vend të prekur thellë nga shkelja e të drejtave të njeriut, mosbesimin mes grupeve etnike, mohimi i vuajtjeve të së kaluarës dhe me mungesë të potencialit institucionale për ndryshime të mëdha. Zhvendosja nga konflikti i armatosur dhe represioni në gjendje paqe dhe demokracie funksionale kërkon nga shoqëria të “ketë qëndrim ndaj shkeljeve masive të të drejtave të njeriut që ndodhën në të kaluarën jo të largët”¹. Ky punim merret me problemet politike, ligjore dhe morale me të cilat përballlet shoqëria kosovare, në përpjekjet e saj për të kaluar nga një shoqëri e përshtuar me dhunë dhe mungesë qëndrueshmërie në shoqëri të qëndrueshme, funksionale e të lirë.

Me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova u bë shteti i fundit që doli nga shpërbërja e Jugosllavisë. Gjersa vendi po vendos themelet e një fillimi të ri, është me rëndësi që ai të përqendrohet në shërimin e plagëve nga e kaluara traumatike dhe të ngashëroj hidhërimin e pranishëm te popullata. Ky moment historik paraqet mundësi të mirë për rolin e ri të Kosovës, populli i së cilës ende kërkon përgjigje dhe sqarim për të kaluarën e tij.

Me dhjetëra pyetje sillen vërdallë në popullatë sa rreth luftës, viktimave, të pagjeturve, kryesve të krimeve, pasojave të periudhës së pas-çlirimit të vitit 1999, qeverive, personave përgjegjës. Mungesa e përgjigjeve dhe e sqarimeve ka shkaktuar huti dhe shqetësim që nga përfundimi i luftës. Vetë e kaluara e Kosovës vazhdon të jetë temë e shpjegimeve kundërthënëse të shqiptarëve të Kosovës nga njëra anë dhe serbëve të Kosovës dhe Serbisë në anën tjetër. Këto shpjegime përmbajnë dallime qenësore rreth asaj se çfarë ka shkaktuar luftën dhe një gjë e tillë vazhdon të mbetet burim konflikti ndërmjet dy grupeve etnike. Në mënyrë që të parandalohet ndonjë pasojë e papritur në zhvillimin demokratik të Kosovës dhe në mënyrë që të vendosen themelet e një shoqërie normale, debati konstruktiv për të kaluarën është në dobi për të gjithë popullin e Kosovës.

Mungesa e komunikimit mes grupeve etnike që jetojnë në Kosovë shkakton paragjykim dhe mungesë të mirëkuptimit. Paragjykimi, siç mund të shihet nga pjesa për historikun të kësaj analize ka shpjer në urrejtje ndëretnike në Kosovë dhe i ka shkaktuar popullatës vuajtje të papara. Politikat shtetërore tiranike të Serbisë dhe paraqitja e shqiptarëve si një kërcënim ekzistencial për ekzistimin e shtetit të Serbisë ndezën luftën në Kosovë në vitin 1998, përderisa fajësimi dhe urrejtja e kanë ndezur konfliktin e marsit të vitit 2004. Çmimi ka qenë jashtëzakonisht i madh. Me mijëra njerëz kanë humbur jetën dhe qindra të tjerë mbesin të zhdukur. Me qindra mijëra kanë humbur pronën e tyre dhe me miliona ende përballen me trauma. Vetëm në përballje me këto dhembje populli i Kosovës do të gjejë rrugën për një të ardhme paqësore.

* Autorët u janë mirënjohës Bob Deen dhe Robert Schupp nga zyra e Komisionarit të lartë të OSBE-së për pakica kombëtare për përkrahjen e vazhdueshme të tyre, Caitlin Reiger, Dorothee Marotine, Mark Freeman dhe Dick Oosting nga Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale për komentet e tyre të vlefshme, Burim Ejupit për ndihmën e pamashë gjatë projektit, Emilie Ceron për ndihmë gjatë hulumtimit dhe të gjithë të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në fokus-grupe.

¹ E njëjta gjë vlen për republikat e ish Jugosllavisë, Kroacinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinë. FDH. “Drejtësia kalimtare në vendet Post-Jugosllave: Raport për vitin 2006”. Fondi për të drejtën humanitare; Dokumente; Qendra për hulumtime dhe dokumentim -Sarajevë.

Pasi ofron një vështrim të shkurtë të ngjarjeve historike kryesore të dekadës së fundit në Kosovë, punimi prek çështje të shumta që kanë penguar zhvillimin e duhur të shoqërisë së Kosovës dhe që vazhdojnë të paraqesin pengesa në fuqizimin e paqes së brishtë të saj. Analiza merr parasysh dhe i adreson çështjet si në vijim: cili është koncepti i drejtësisë tranzicionale dhe çfarë lidhje kanë me të historiku i Kosovës dhe gjendja e tanishme? Cilat janë çështjet kryesore sa i përket popullatës së Kosovës në lidhje me ballafaqimin me të kaluarën? Cilët janë hisedarë kryesore dhe çfarë masa janë ndërmarrë për t'u përballuar me të kaluarën?

Padrejtësitë e së kaluarës që mbesin pa u adresuar shumë lehtë mund të bëhen burim konflikti dhe i tensioneve të reja, ndërsa mosndëshkimi e shkatërron besimin në institucione dhe pengon normalizimin e kontakteve mes bashkësive. Ndonëse është e kuptueshme që secila bashkësi e sheh drejtësinë tranzicionale dhe pajtimin nga perspektiva të ndryshme, debati për këta mekanizma dhe si ato më së miri do të mund të zbatoheshin në Kosovë është e një rëndësie thelbësore për të gjithë. Në të njëjtën kohë, një proces i tillë i ballafaqimit me të kaluarën nuk mund të ndodhë pa përfshirjen e të gjitha grupeve. Viktimat në Kosovë kanë shumë pyetje pa përgjigje dhe shumë plagë që kanë nevojë të shërohen. Përfundimi i periudhës së dhunës ka rezultuar me një stabilitet politik në dukje dhe qeveria e Kosovës deri më tani ka dështuar për të marrë rolin udhëheqës për marrjen e masave të ofrimit të drejtësisë për shumë viktima.

Një trajtim afatgjatë nevojitet për Kosovën për të shpejtuar ndjekjet penale, të shfrytëzohen mekanizma alternativë për të përkrahur viktimat dhe familjet e tyre dhe për të vendosur metodë gjithëpërfshirëse të angazhimit të pjesëve të ndryshme të shoqërisë për të diskutuar trashëgiminë e së kaluarës dhe mundësitë për të ardhmen. Kjo kërkon qasje afatgjatë, si pjesë e një strategjie më të gjerë të qeverisë.

Metodologjia

Konteksti më i gjerë i punimit për drejtësinë tranzicionale me të gjitha çështjet dhe konceptet që ajo i përfshin është përmbledhur përmes hulumtimeve, konsultimit të literaturës mbi drejtësinë tranzicionale, publikimeve të Qendrës ndërkombëtare të drejtësisë tranzicionale (QNT), artikujve të shqyrtuar që shtellojnë të vërtetën dhe pajtimin përmes rasteve studimore të ndryshme, etj. Për të paraqitur një pasqyrë të qartë të kontekstit të Kosovës dhe për të provuar që t'u përgjigjemi pyetjeve të përmendura më lart, një varg i intervistave janë bërë me zyrtarë qeveritarë, deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile aktive në Prishtinë dhe Beograd, përfaqësues të shoqatave të viktimave në Kosovë, ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë dhe aktivistë për çështje të drejtave të njeriut të cilët merren me të kaluarën, si dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Gazetat vendore dhe raportet e organizatave për të drejtat e njeriut janë këshilluar për të marrë informata shtesë për perceptimin nga vendorët. Raporti i UNDP mbi perceptimet e publikut për drejtësinë tranzicionale është përdorur për të paraqitur informatën e vetme statistikore ekzistuese në Kosovë sa i përket perceptimeve të qytetarëve për mekanizmat e ndryshëm të drejtësisë tranzicionale (ndjekjet penale, kërkimi i të vërtetës etj) bazuar në etnicitet. Gjithashtu, përgjatë analizës, është caktuar një grup me ekspertë vendorë në çështje të drejtave të njeriut, sistem të drejtësisë, persona të pagjetur dhe

integrim të bashkësive për të diskutuar dhe debatuar sfidat që Kosova i has gjatë përballjes me të kaluarën.

2. Drejtësia tranzicionale – koncepti dhe mekanizmat kryesorë të saj

Drejtësia tranzicionale është fushë shumë-disiplinore, e përqendruar te viktimat dhe që merret me pasojat e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut. Ajo është e lidhur me luftën kundër mos-ndëshkimit dhe aspekte të ndërlidhura të të drejtave të njeriut dhe zgjidhjes së konfliktit². Synimet e saj të drejtpërdrejta janë që t'i japin fund mos-ndëshkimit dhe t'ua kthejnë dinjitetin viktimave, gjersa me synimet afat-gjata të saj përpiqet të ndihmojë në parandalimin e konflikteve duke rivendosur besimin qytetar, pajtimin dhe sundimit e ligjit dhe rendit demokratik.

Drejtësia tranzicionale përqendrohet në sfidat që shoqëritë në fazën e tranzicionit – nga lufta në paqe apo nga sundimi autoritar në demokraci – përballen me pasojat e shkeljeve masive. Metodot dhe qasjet e drejtësisë tranzicionale gjithashtu mund të përdoren në rastet tjera, përfshirë edhe rastet e demokracive të ngritura që merren me pasojat e shkeljeve më të largëta në kohë.

Ndonëse termi “drejtësi tranzicionale” nuk ka hyrë në përdorim në fjalorin politik deri në periudhën e hershme të pas-luftës së ftohtë, prejardhja historike daton qysh nga gjykimet e Nurembergut apo edhe me herët. Si doktrinë juridike, fusha e drejtësisë tranzicionale e ndjek inspirimin e saj parësor në jurisprudencën e traktateve të organeve të KB-së dhe të gjykatave dhe komisioneve mbi-kombëtare rajonale të të drejtave të njeriut. Pjesët kryesore të asaj jurisprudence drejtpërdrejt janë konfirmuar në shumë dokumente të rëndësishme të KB-së si raportet e viteve, 1997, 2004 e 2005 të raportuesve të posaçëm të KB-së në luftën kundër mosndëshkimit dhe të raportit të vitit 2004 të Sekretarit të Përgjithshëm për *Sundimi i ligjit dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë gjatë dhe pas konfliktit*³.

Edhe pse kontekstet tranzicionale provokojnë një varg të madh dilemash morale, juridike dhe politike, sfida e të përballurit me të kaluarën është ndër më të vështirat. Kjo për arsye se ka prirje për të pasur kufizime të shumta të aftësive dhe politikave që e ndrydhnin mundësitë e zgjedhjeve të qeverive në luftimin pasojave të shkeljeve të së kaluarës. Në këto kufizime përfshihen, sistemi i dobët gjyqësor, korrupsioni tipik, paqja e brishtë, numri i madh i keqbërësve dhe viktimave si dhe pengesat ligjore apo kushtetuese si ligjet për amnistinë. Në këto kontekste drejtësia e plotë dhe e menjëhershme praktikisht është e pamundur por çka kërkohet në këtë rast është përpjekja e sinqertë për të kërkuar të vërtetën si dhe drejtësi, pajtim dhe reforma institucionale sa më të mëdha që është e mundur.

Në nivelin operativ, drejtësia tranzicionale ndiqet përmes pesë mekanizmave kryesorë: ndjekjes penale, gjetjes së të vërtetës, zhdëmtimit të viktimave, reformimit të sektorit të

² Shih, p.sh., Kritz, Neil (ed.), *Drejtësia kalimtare: Si përballen demokracitë e reja me ish regjimet*, Uashington, DC:SHBA Instituti për Paqe Gazeta, vol. 3 (1995). Po ashtu shih www.ictj.org.

³ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm *Sundimi i ligjit dhe drejtësia kalimtare në shoqëritë gjatë dhe pas konfliktit*. shih: <http://daccess-ods.un.org/TMP/3868815.html>

sigurisë si dhe të mos harresës e përkujtimit⁴. Në projektimin dhe zbatimin e mekanizmave të tillë, drejtësia tranzicionale e përqendron vëmendjen në të drejtat dhe interesin e viktimave dhe familjeve të tyre duke i marrë parasysh posaçërisht nevojat e veçanta si dhe të ardhmen e fëmijëve dhe grave.

Praktikisht dhe konceptualisht, mekanizmat e drejtësisë tranzicionale kanë nevojë për njëri tjetrin. Për shembull, pa tregimin e së vërtetës, reforma institucionale apo orvatja për zhdëmtim, gjykimi i një numri të kufizuar të keqbërësve mund të kuptohet si kurban apo formë e revanshizmit politik. Vetëm të treguarit e së vërtetës pa orvatje për të dënuar keqbërësit, reformimin institucional dhe ndihmës për viktimat mund të kuptohet asgjë më shumë se vetëm si fjalë. Zhdëmtimi pa asnjë lidhje me masat e tjera të drejtësisë tranzicionale mund të kuptohet si orvatje për të “blerë” heshtjen apo pranimin në heshtje të viktimave. Ngjashëm, të reformuarit e institucioneve pa asnjë orvatje për të kënaqur pritjet e legjitime për drejtësi, të vërtetën dhe zhdëmtim të viktimave është joefikas nga këndvështrimi i përgjegjësisë dhe vështirë të jetë i suksesshëm në kushte të tilla. Prandaj, qasja e drejtësisë tranzicionale vë theksin mbi strategjitë e njësuara apo gjithëpërfshirëse e të ballafaqarit me të kaluarën

Praktikisht dhe konceptualisht, mekanizmat e drejtësisë tranzicionale kanë nevojë për njëri tjetrin. Qasja e drejtësisë tranzicionale vë theksin mbi strategjitë e njësuara apo gjithëpërfshirëse e të ballafaqarit me të kaluarën.

Edhe pse nuk ekziston një formulë e vetme për t'u ballafaqar me të kaluarën e që është shënuar me shpërdorim sistematik dhe në mënyrë masive, drejtësia tranzicionale na mëson që zgjedhjet që shoqëria i bën kanë më shumë gjasa të jenë efikase kur ato bazohen në studimin serioz të përvojave paraprake kombëtare e ndërkombëtare. Një studim i tillë zvogëlon mundësinë e përsëritjes së gabimeve që do të mund të evitoheshin. Sigurimi i këshillimeve aktive dhe pjesëmarrja e grupeve të viktimizuara dhe publikut në masë të madhe është faktor vendimtar. Pa këshillime dhe pjesëmarrjeje të tillë perspektiva e planifikimit dhe veprimit të një politike efikase dhe të besueshme të drejtësisë kalimtar zvogëlohet shumë.

a) Ndjekjet penale për krime ndërkombëtare

Gjykimet dhe ndjekjet penale shihen nga shumica⁵ si mënyra më e rëndësishme e drejtësisë tranzicionale. Është me të vërtetë normale që kjo duhet të jetë kështu duke parë natyrën serioze të krimeve të përfshira në çdo konflikt apo periudhe të sundimit totalitar.

Përfitimet kryesore të mundshme të drejtësisë penale më së miri mund të arrihen nëse ndjekjet penale bëhen në nivel kombëtar.

Gjykatat penale ndërkombëtare e të përziera të rastit janë shfaqur në vitet e fundit për t'u marrë me ata që mbajnë përgjegjësinë më të madhe për mizoritë që u përhapën në vende e rajone të caktuara si Ruanda, Ish-Jugosllavia,

⁴ Lista është variant i ndryshuar i modelit të paraqitur nga Natascha Zupan në artikullin e saj “Ballafaqimi me të kaluarën dhe Drejtësia Kalimtare të vendeve të ish Jugosllavisë” në: Martina Fischer (ed.) Ndërtimi i paqes dhe shoqëria civile në Bosnje dhe Hercegovinë: Dhjetë vite pas Dejtonit. Münster: Lit Verlag, f. 327-342 (2006). Modeli i Zonjës Zupan përfshin po ashtu edhe këta mekanizma: Pastrimi, Pajtimi i bazuar në bashkësi, Shërimi dhe tregimi i ngjarjeve.

⁵ Shih, p.sh. Zyra e Komisionarit të Lartë të KB-së për të Drejtat e Njeriut, *Mjetet e sundimit të ligjit për shtetet pas konfliktit: Nismat për ndjekje penale* (2006), <http://www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawProsecutionsen.pdf>

Sierra Leone dhe Timori Lindor. Veç kësaj, themelimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare tregon vendosmërinë dhe gatishmërinë ndërkombëtare për t'i gjykuar rastet më serioze të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit si dhe të krimeve të luftës. Po ashtu, shumë ndjekje penale janë bërë në vendet e treta, përmes mbështetjes në parimet juridike si jurisdikcioni universal apo alternativisht në bazë të zotimeve të shteteve që kanë për traktate të caktuara.

Nga perspektiva e drejtësisë tranzicionale, është e pëlqyeshme që ndjekjet penale të bëhen në nivel kombëtar, sepse në atë nivel përfitimet më të rëndësishme të mundshme të drejtësisë penale më së miri mund të arrihen, domethënë: të ndihmohet në përmbajtjen nga shkeljet e të drejtave në të ardhmen, të shprehet dënimi në mënyrë publike të veprimit penal, të sigurohet formë e drejtpërdrejtë e përgjegjësisë ndaj kryerësve të krimeve mizore dhe të ndihmohet në rivendosjen e besimit të publikut në sundimin e ligjit.

Rritja domethënëse kohëve të fundit e përpjekjeve për drejtësi penale në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare ka qenë përbërës themelor në formësimin e debatit global se si të luftohet me pasojat e shkeljeve masive të të drejtave. Disa analistë theksojnë që ndikimi i ndjekjes penale në arsimimin e publikut në lidhje me padrejtësinë në të kaluarën dhe realizimi i transformimit të konfliktit ka gjasa të jetë i kufizuar⁶. Megjithatë, edhe pse ndikimi mbetet i kufizuar, rëndësia e ndjekjes penale mendohet të jetë e madhe. Padyshim ky është rasti me ish Jugosllavinë, ku ka pasur shumë ndjekje penale (përfshirë këtu edhe ato përmes Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNJ)) por që janë përdorur pak mekanizmat e tjerë të drejtësisë tranzicionale⁷. Në fakt, edhe pse shumica e shprehin pakënaqësinë e tyre me punën e gjykatave, pakënaqësia e tyre është më e madhe me çka konsiderohet si mungesë absolute e mjeteve të tjera ekzistuese.

b) Komisionet e së vërtetës

Kërkimi i së vërtetës⁸ është nocion i gjerë që përfshin metoda të ndryshme të mbledhjes së informatave. Siç shpjegohet në Enciklopedinë e Gjenocidit, kërkimi i së vërtetës mund të ndiqet “përmes krijimit të komisioneve të së vërtetës apo përpjekjeve tjera kombëtare, si përfshirja në hulumtime të mëdha historike, mbledhja e dëshmimeve apo historive gojore të viktimave, përkrahja në punën e antropologëve mjeko-ligjorë në përcaktimin e saktë të natyrës së vdekjes së viktimave, apo zhvarrosjen e trupave të të vrarëve”⁹.

Mënyra më së shumti e njohur e të kërkuarit të së vërtetës në kontekstin kalimtar është komisioni i së vërtetës. Komisionet e së vërtetës janë komisione ad-hoc të hetimit të themeluara dhe të autorizuara nga shtetet për qëllim të vetëm të hetimit dhe raportimit për periudha të kyçe të shkeljeve në të kaluarën e afërt dhe dhënia e rekomandimeve për t'i riparuar shkeljet e tilla

Vetëdijesimi i publikut dhe debati publik për shkeljet e bëra në të kaluarën është parakusht themelor për çdo proces kuptimplotë pajtimi

⁶ Osiel, Mark. Mizoritë masive, kujtesa kolektive dhe ligji, New Brunswick, N.J.: Transaction Publishers (1997).

⁷ H.L.C. 2006 Report. Op.cit, p.5.

⁸ Shih, p.sh. Zyra e Komisionarit të Lartë të KB-së për të Drejtat e Njeriut, *Mjetet e sundimit të ligjit për shtetet pas konfliktit: Nismat për ndjekje penale* (2006),

<http://www.ohchr.org/Documents/Publications/RuleoflawTruthCommissionsen.pdf>

⁹ Enciklopedia e Gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit (Macmillan Reference SHBA (2004), vol. 3, pp. 1045-1047. Marrë nga <http://www.ictj.org>.

dhe parandaluar rishfaqjen e tyre. Janë krijuar shumë komisione të së vërtetës në tërë botën gjatë dekadave të fundit në vende si Argjentinë, Haiti, Marok dhe Liberi¹⁰. Më i njohuri mbetet Komisioni i së Vërtetës dhe i Pajtimit në Afrikën e Jugut (KVP), me gjykimet publike të transmetuara ndërkombëtarisht. KVP-ja ende mbetet i vetmi komision i së vërtetës që ka pasur autoritet të ofroj amnisti por që shpesh është keqkuptuar dhe ka shpjer gabimisht në refuzimin e komisioneve të së vërtetës si organe që nuk i japin rëndësi përpjekjeve për drejtësi edhe pse të dhënat e shumicës së komisioneve tregojnë krejt të kundërtën.

Gjithashtu, komisionet e së vërtetës përqendrohen te viktimat dhe shumica e komisioneve bashkëkohore të së vërtetës kanë mbajtur gjykime publike për viktimat. Gjykimet e tilla duket se kanë bërë rritje domethënëse të vetëdijesimit të publikut dhe të debatit publik për shkeljet e bëra në të kaluarën – një parakusht themelor për çdo proces kuptimplotë pajtimi. Të frymëzuar nga KVP-ja si dhe të komisioneve tjera të së vërtetës të mëpastajme, sot shumica gjithashtu përdorin procedura të hapura pjesëmarrëse për të zgjedhur komisionarët. Shumica po ashtu përpiqen të këshillohen në mënyrë aktive dhe të përfshijnë shoqërinë civile vendore dhe viktimat – para, gjatë dhe pas operacioneve – për të përmirësuar ligjshmërinë dhe besueshmërinë të vetë procesit dhe rezultatit përfundimtar.

Komisionet e së vërtetës veprojnë për një periudhë të caktuar kohore, kanë mandate të veçanta, shfaqin përgatitje të shumëllojshme organizative dhe miratojnë një varg procesesh dhe procedurash me synim të përpilimit dhe shpërndarjes të raportit përfundimtar përfshirë këtu edhe përfundimet dhe rekomandimet. Përfundimisht, synimet e komisioneve të tilla janë të ndihmojnë në përfundimin dhe llogaridhënien e shkeljeve të bëra nga autoritetet, për të promovuar pajtimin kombëtar dhe/ose të përkrahin rendin e ri politik apo t'i përligj politikatat e reja¹¹.

c) Dëmspërblimet

Programet e dëmspërblimeve të viktimave¹² janë nisma të sponsoruara nga shteti që synojnë të ndihmojnë në dëmspërblimin, në shkallë të gjerë dhe të konsiderueshme, të pasojave materiale dhe morale të shkeljeve të përjetuara nga kategori të caktuara të viktimave. Programet e tilla përbëjnë gjest të rëndësishëm të pranimit dhe përkrahjes nga shteti që shërbejnë për të plotësuar më shumë mekanizma të përgjegjshëm të drejtësisë tranzicionale. Ato po ashtu ndihmojnë të plotësojnë “boshllëkun e paanësisë” që përndryshe do të rridhte nga, në njërën anë, pamundësisë për korrigjimin universal e të drejtë financiar

Dëmspërblimet ndihmojnë të plotësojnë “boshllëkun e paanësisë” që përndryshe do të rridhte, përveç tjerash, të pamundësisë për korrigjimin universal e të drejtë financiar përmes procedurave gjyqësore

përmes procedurave gjyqësore dhe në anën tjetër të masës së zakonshme – përmes çarmatimit, demobilizimit dhe programeve integruese – të përfitimeve financiare të kryerësve veprimet e të cilëve që në fillim ndikuan në nevojën për zhdëmtimin e viktimave.

Programet bashkëkohore të dëmspërblimit zakonisht u ofrojnë pagesa viktimave dhe familjeve të tyre së bashku

¹⁰ Për listë më të detajuar referohuni: Freeman, Mark, *Komisionet e së vërtetës dhe paanësia procedurale*, Cambridge University Press (2006).

¹¹ Për listë të detajuar të komisioneve të së vërtetës në tërë botën dhe raportet e tyre shih Përmbledhjen digjitale të Komisioneve të së vërtetës nga Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara në: <http://www.usip.org/library/truth.html>

¹² Për listë më të detajuar referohuni: Freeman, Mark, *Komisionet e së vërtetës dhe paanësia procedurale*, Cambridge University Press (2006).

me qasje të privileguara apo të veçanta në shërbime të caktuara publike apo private, si kujdesi shëndetësor rehabilitues, përfitime pensionesh dhe shërbime arsimore. Programet bashkëkohore të dëmshpërblimit gjithnjë e më shumë përfshijnë forma të ndryshme simbolike të dëmshpërblimit përfshirë këtu edhe monumentet dhe memorialët për të ruajtur dhe nderuar kujtesën e viktimave. Masat ndjeshme të dëmshpërblimit në baza gjinore dhe atyre të përqendruar te bashkësitë po ashtu po fillojnë të rekomandohen dhe përdoren.

Viteve të fundit ka pasur përparim të ndjeshëm në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare në dëmshpërblim për krimet më të mëdha¹³. Kuptimi bashkëkohor i dëmshpërblimit është shumë i gjerë. Ai përfshin kompensimin, që nënkupton përfshirjen e çdo dëmtimi të mundshëm ekonomik si pasojë e krimit, përfshirë “lëndimin fizik ose mendor; rastet e humbura, përfshirë humbjen e mundësisë të të fituarit; dëmtimin moral; shpenzimet që kërkohen për ndihmë juridike apo ekspertizë, barëra ose shërbime mjekësore, dhe shërbime psikologjike dhe sociale”¹⁴. Pikëpamja bashkëkohore e dëmshpërblimit gjithashtu përfshin idenë e “dëmshpërblimit” të të drejtave dhe përfitimeve, përfshirë “lirinë, gëzimin e të drejtave të njeriut, identitetin, jetën familjare dhe shtetësinë, kthimin në vendbanim, ripunësimin dhe kthimin e pronës”¹⁵. Standardi ndërkombëtar i dëmshpërblimit gjithashtu përfshin programet rehabilituese si “kujdesin mjekësor dhe psikologjik si dhe shërbimet juridike dhe sociale,”¹⁶ e po ashtu edhe një varg të madh të masave simbolike si kërkim-falja personale dhe shtetërore¹⁷.

Ndonëse mund të mos quhet si zgjidhje nga të gjithë, njohja e statusit të viktimës mund të ndihmojë shumë në ofrimin e satisfacionit për viktimat. Mbështetja ligjore e statusit të viktimave të shoqëruara me mekanizmat rehabilitues do të ndihmonte procesin kombëtar dhe do të rriste besimin te institucionet. Për shkak të mungesës së mekanizmave rehabilitues për viktimat, viktimizimi i tyre në shoqëri mund të vazhdojë madje mund të rrezikojë sigurinë e tyre dhe të shkaktojë shpërngulje. Ky është zakonisht rasti me viktimat e dhunimit që ende më tej ndiqen nga shoqëria madje nga vetë grupi i tyre etnik. Dëmshpërblimet materiale ofrojnë mjete shtesë që ndihmojnë viktimën në përballjen me vuajtjet e tij/saj.

d) Reforma e sistemit të sigurisë

Një vend në fazë kalimtare i dalë nga konflikti apo nga një qeveri keqberëse pashmangshëm duhet të reformojë institucionet e tij për të garantuar, sa më shumë që është e mundur, mos-përsëritjen e shkeljeve. Kjo posaçërisht vlen për institucionet që e përbëjnë sistemin e sigurisë shtetërore.

Ekziston një varg i gjerë i reformave të mundshme që shteti mund t'i merr parasysh për t'i miratuar në kontekstin kalimtar, përfshirë këtu edhe largimin nga shërbimi publik të personave që kanë kryer shkelje, shpërndarja e institucioneve që kanë kryer shkelje apo themelimi i të reja që do t'i mbronin

Drejtësia kalimtare i jep theks të veçantë “programeve të regjistrimit dhe identifikimit” veçanërisht në polici, ushtri dhe gjyqësi

¹³ Shih posaçërisht: *Parimet bazë dhe udhëzimet për të drejtën në mjete dhe zhdëmtim për viktimat e shkeljeve flagrante të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare*, Resoluta 60/147, Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, *mbledhja plenare e 64-të*, të 16 dhjetorit 2005: <http://www2.ohchr.org/english/law/remedy.htm>

¹⁴ *Parimet bazë dhe udhëzimet për të drejtën në mjete dhe zhdëmtim për viktimat e shkeljeve flagrante të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare*, Op. Cit, para.20.

¹⁵ Po aty, para.11.

¹⁶ Po aty, para.21.

¹⁷ Po aty, para.22.

më mirë të drejtat e njeriut, krijimin e programeve të trajnimit për të drejtat e njeriut dhe futja në përdorim të ndryshimeve ligjore dhe kushtetuese për përmirësimin e qeverisjes.

Në praktikë, sfera e drejtësisë tranzicionale i jep theks të veçantë “programeve të regjistrimit dhe identifikimit”¹⁸ dhe “programeve korigjuese,”¹⁹ veçanërisht në polici, ushtri dhe gjyqësi. Programi i mëparshëm është, në thelb, kontroll teknike e institucionit publik për të vërtetuar gjendjen aktuale të anëtarësisë e që shpesh është shtrembëruar shumë nga konfliktet e mëhershme dhe keq menaxhimi. Programet e regjistrimit dhe identifikimit përpiqen të sajojnë një lloj të “përfundimit” të kufijve formal të institucioneve në mënyrë që proceset pasuese të reformave të jenë më të kontrolluara dhe më efektive. Këto programe shpesh paraqesin hapin e parë themelor drejt rivendosjes së sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Korigjimi është i përpiluar të vlerësojë kompetencën dhe integritetin e personit. Programet korigjuese janë procedura që përqendrohen në integritetin e personelit e që kanë si qëllim të vetin shndërrimin e institucioneve të caktuara publike – veçanërisht të sektorit të sigurisë – nga instrumentet e represionit dhe korrupsionit në instrumente të vërteta të shërbimeve

Programet korigjuese janë procedura që përqendrohen në integritetin e personelit. Qëllimi i tyre është shndërrimi i institucioneve të caktuara publike në instrumente të vërteta të shërbimeve publike.

publike. Një program korigjues i zakonshëm përfshin tri faza kryesore: regjistrimi në program, që mund të jetë edhe i obligueshëm, vlerësimi i kandidatëve në bazë të informatave të dhëna në formularët vetë të plotësuar të regjistrimit, e po ashtu informatave të marra përmes burimeve të pavarura dhe të besueshme; dhe pranimi ose mos pranimi të atyre që shihen si të përshtatshëm apo të pa përshtatshëm, sipas rastit, për të punuar në institucionet publike në

fjalë. Mekanizmat korigjues duhet të jenë në pajtim me parimet bazë të paanësisë procedurale. Në këtë kuptim është me rëndësi të ceket se programet e tilla përpiqen të sigurojnë më shumë paanësi sesa të ashtuquajturat programet e diskutueshme të “pastrimit” të përdorura më herët në shumicën e shteteve të Evropës lindore. Megjithëse disa e konsiderojnë “pastrimin” si program më të favorshëm sepse është mekanizëm më i shpejtë që u lejon “atyre me më pak faj t’i ikin burgut”²⁰, lustracioni është masë kolektive kundër të gjithë njerëzve të lidhur me organet e shtetit të kaluar apo me ndërmarren politike të tij. Kjo bie ndesh me parimin e përgjegjësisë personale që drejtësia tranzicionale i vë theks të veçantë²¹.

Aparati shtetëror që ka funksionuar gjatë periudhës së represionit duhet të reformohet dhe në këtë mënyrë të jetë në përputhje me shndërrimet politike në mënyrë që të rifitoj besimin e qytetarëve dhe të gjitha bashkësitë etnike të vendit. Në këto institucione përfshihen ato më të rëndësishmet si sektori i sigurisë dhe gjyqësori. Reformat përfshijnë hapjen e dosjeve sekrete dhe kontrollimin e duhur të veprimeve personale gjatë kohës së luftës apo periudhës së shtypjes para ri-angazhimit të tyre në funksione publike e veçanërisht në fushën e drejtësisë. Veç kësaj, vendosja e kornizës së duhur ligjore si dhe trajnimin e plotë të

¹⁸ Shih botimin e GJNPJ-së në: <http://www.ictj.org/images/content/8/0/801.pdf>

¹⁹ Zyra e Komisionarit të Lartë të KB-së për të Drejtat e Njeriut, *Mjetet e sundimit të ligjit për shtetet pas konfliktit: Korigjimi:korniza vepruese*, prill 2006,

²⁰ Bleeker, Mô dhe Sisson, Jonathan (Eds). Ballafaqimi me të kaluarën: Çështjet vendimtare, Mësimet e marra dhe sfidat për policinë e ardhshme të Zvicrës. Swiss Peace KOFF Series Nr. 2/2004, f.25.

²¹ Raporti i vitit 2006 i HLC, f. 19.

gjyqtarëve dhe prokurorëve është thelbësore për funksionimin demokratik dhe të pavarur të sistemit të drejtësisë.

e) Kujtesa dhe përkujtimi

Sipas definicionit akademik, kujtimi dhe nderimi i viktimave janë pjesë e qasjes së përgjithshme të të ballafaquarit me shkeljet. Këto mund të bëhen përmes masave të ndryshme “përfshirë këshillimin me viktimat për të ndërtuar memoriale dhe muze përkujtuese, shndërrimin e hapësirave publike si ish-kampet e burgimit në parqe përkujtimi dhe hapësira shpjegimi dhe përshpejtimin e dialogut social dobiprurës për të kaluarën”²².

Kujtesa dhe përkujtimi tani shihen si përbërës të rëndësishëm i katër mekanizmave kalimtarë më shumë tradicional të drejtësisë. Shumica e arsyeve faktin që kujtesa e përbashkët ndihmon në krijimin e “e vërtetës zyrtare” për brezat e ardhshëm. Kjo do të ndihmonte më pastaj në parandalimin e keqpërdorimit të numrave në çështjet e ndjeshme si viktimat dhe personat e humbur nga politikanët.

Arsimimi formal dhe jo-formal mund po ashtu të prodhojë zhvillim thelbësor sa i përket kujtesës dhe pajtimit për të kundërshtuar variantin përzgjedhës të shoqërisë së “re”. Megjithatë, ndarja e sistemit arsimor në vija etnike dhe kombëtare është shpesh pengesë e madhe në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të vlerave dhe tolerancës, respektit të të drejtave të njeriut dhe demokracisë.

Kujtesa e përbashkët ndihmon në krijimin e “e vërtetës zyrtare” për brezat e ardhshëm. Kjo do të ndihmonte në parandalimin e keqpërdorimit të numrave në çështjet e ndjeshme nga politikanët.

f) Përvojat rajonale

Shumë vende kanë formuar mekanizmat e drejtësisë tranzicionale për t’u përballuar me pasojat e së kaluarës së tyre. Që nga dëshmipërblimi gjerman për hebrenjtë pas Luftës së Dytë Botërore deri te Komisioni Kombëtar për Personat e Zhdukur në Argjentinë pastaj ndjekja penale ndaj ish-kryetarit Charles Taylor para Gjykatës Speciale për Sierra Leonen, ka raste të shumta të proceseve të rëndësishme në vendet që dalin nga regjimet autoritare apo periudhe konflikti. Në anën tjetër, ka raste me pasoja negative të mospranimit apo pazotësisë të një shteti për t’u përballur me të kaluarën e tij, si përtëritja e dhunës në Timorin Lindor pjesërisht për shkak të mungesës së korrigjimit të agjencive të sigurimit pas vitit 1999.

Vendet e ish-Jugosllavisë janë përballur me pasojat e konfliktit të viteve 90-ta në mënyra të ndryshme dhe me shkallë të ndryshueshëm të suksesit. Ka disa shembuj të mëhershëm shumë të rëndësishëm që mund të bazohemi para se të fillohet ndonjë proces në Kosovë. Një shembull nga çdo mekanizëm i drejtësisë tranzicionale do të ceket më poshtë.

Ndjekja penale e krimeve të luftës të bëra gjatë konfliktit në territorin e ish-Jugosllavisë kanë ngjarë në nivel kombëtar në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Serbi si dhe në nivel ndërkombëtar përmes Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë (GJNKJ). Pavarësisht nga konteksti politik jo i favorshëm që ka rrethuar ndjekjen e kryerësve të krimeve të luftës në Serbi nga Dhoma për Krime të Luftës e Gjykatës së Qarkut në Beograd, gjykimet janë ndihmesë e rëndësishme për përpjekjet e përgjithshme në krijimin e

²² Enciklopedia e Gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit, op.cit.

përgjegjësisë në rajon. Dhoma për Krime të Luftës si dhe Zyra e Prokurorit për Krime të luftës e Republikës së Serbisë ligjërisht u themeluan në korrik të vitit 2003²³ dhe filluan punën brenda gjashtë muajve. Një numër të metash dhe problemesh u gjetën në lidhje me këto institucione, si mungesa e burimeve, bashkëpunimi i papërshtatshëm mes prokurorit dhe policisë, frikësimi i dëshmitarëve apo pengesat në mbrojtje adekuate²⁴. Megjithatë, Dhoma për Krime të Luftës dhe Zyra e Prokurorit për Krime të luftës viteve të fundit i kanë zhvilluar aftësitë e tyre dhe janë të aftë t'u ofrojnë drejtësi viktimave të shumta të krimeve të luftës.

Nismat vendore në rajon për komisionet e së vërtetës janë bërë eufemizëm i përpjekjeve të dështuara. Në Serbi, Kryetari i atëhershëm Koshtunica e themeloi më 2001 Komisionin Jugosllav të së Vërtetës dhe Pajtimit, që nxjerri në shesh shumë mësim të rëndësishme se çka nuk duhet bërë²⁵. Komisioni nuk ishte kuptuar si paanshëm sepse përbërja e tij ishte shumë serbe dhe në të mungonte përfaqësimi i duhur i pakicave kombëtare, bashkësive fetare dhe shoqërisë civile. Komisioni për shkak të mungesës së këshillimeve dhe debatit rreth krijimit të tij nuk ishte konsideruar si nismë e besueshme nga shoqëria civile dhe akterët politik. Mandati i komisionit u përqendrua në shkaqet e luftës dhe mizoritë lidhur me të sesa në ndikimet e saj dhe kjo do të mund të ishte përpjekje e besueshme po të ishin përfaqësuar bashkësitë e ndryshme në komision. Në fund, komisioni dështoi të ofroj raportin apo të bëjë rekomandime para se të shpërbëhej më 2003.

Zhdëmtimi i viktimave të luftës ka ndodhur në mënyra të ndryshme në rajon, përmes dëmshpërblimit financiar, kthimit të të drejtave dhe ngritjes së memorialëve për viktimat. Bosnja dhe Hercegovina ka kryer një proces shumë të suksesshëm të kthimit të pronës²⁶, duke zgjidhur rreth 95% të 200,000 padive të paraqitura te autoritetet vendore²⁷. Procesi ka kaluar nga miratimi i ligjeve të ndryshme në nivel të bashkësive në një kornizë ligjore të miratuar nga bashkësia ndërkombëtare si Plani i Zbatimit të Ligjit mbi Pronën. Procesi ka filluar me kushtëzimin e ri-posedimit të banesave me kthimin e paditësve në ato banesa, e më vonë ri-posedimit pa kushtin e kthimit duke i mundësuar paditësit që ta shesin pronën e tyre pa i detyruar të jetojnë në një hapësirë ku do të mund të hasnin në diskriminim si pakicë etnike. Ky zhvillim vërtetoi se rikthimi i pronës nuk ishte i vetmi parakusht për kthim vullnetar.

Reformat institucionale në rajon që janë ndërmarrë në lidhje me gjyqësinë kanë pasur më së shumti sukses në Bosnjë dhe Hercegovinë²⁸. Mes viteve 2002 dhe 2004, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Bosnjës dhe Hercegovinës është dashur të ri-aplikojnë për vendet e tyre të punës dhe t'i nënshtrohen procedurës së verifikimit që përfshinte shqyrtimin e

²³ Ligji për organizimin dhe jurisdikcionin e autoriteteve qeverisëse në ndjekjen penale të kryerësve të krimeve të luftës, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 67/2003, 1 qershor 2003 (Ligji për Krime Luftë).

²⁴ Shih raportin e ICTJ: "Against the Current – War Crimes Prosecutions in Serbia (2007)" në <http://www.ictj.org/images/content/7/8/780.pdf>.

²⁵ Shih raportin e ICTJ: "Serbia and Montenegro: Selected Developments in Transitional Justice, tetor 2004", fq. 7-9 në <http://www.ictj.org/images/content/1/1/117.pdf>.

²⁶ Shih raportin e ICTJ: "The Contemporary Right to Property Restitution in the Context of Transitional Justice", maj 2007, faqe 33-41 në http://www.ictj.org/static/PropertyRestitution/Rest_Pub_07.pdf.

²⁷ Shih web-faqen e Misionit të OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë http://www.oscebih.org/human_rights/propertyrepossession.asp?d=1.

²⁸ Shih "Justice as Prevention: Vetting Public Employees in Transitional Contexts", kapitulli 5, në <http://www.ssrc.org/blogs/books/pdfs/vetting/978-0-9790772-1-0-chapter5.pdf>.

përshtatshmërisë të secilit kandidat, zvogëlimin e masës së përgjithshme të gjyqësorit dhe sigurimin e përfaqësimit të përshtatshëm etnik. Aplikacionet ishin shqyrtuar nga Këshillat e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial që fillimisht ishin të përbërë nga vendorët dhe ndërkombëtarët ndërsa më vonë vetëm nga vendorët. Rreth 200 gjyqtarë dhe prokurorë nga 1,000 nuk janë riemëruar. Edhe pse ka pasur tentime të ndërhyrjes politike në proces e edhe pse numri i aplikuesve ishte i kufizuar procesi i riemërimit i arriti qëllimet e tij kryesore dhe ndihmoi në rifitim të besimit të qytetarëve në gjyqësinë e BH.

Suksesi i nismës dhe zbatimit të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale varet nga shumë faktorë, njëri prej tyre është këshillimi, përfshirja dhe fuqia e shoqërisë civile. Në rajoni të ish-Jugosllavisë, shoqëria civile ka fituar përvojën dhe besimin e nevojshëm për të nisur dhe mbajtur debate rreth pasojave të së kaluarës. Qendra Hulumtuese dhe Dokumentuese në Bosnje dhe Hercegovinë mund të shërbejë si një ndër shembujt e mirë. Kjo organizatë është nismëtare e Projektit Humbjet Njerëzore për të përcaktuar numrin dhe emrat e saktë të viktimave të luftës në Bosnje dhe Hercegovinë në mënyrë që të parandaloj keqpërdorimin politik. Përmes hetimit dhe kontrollimit dhe verifikimit të informatave u krijua një bazë e besueshme e të dhënave me hollësi për secilën viktimitë të luftës. Projekti krijoi precedent që po kopjohet në Kroaci dhe Serbi dhe metodologjia që u përdor tani shihet si praktikë e mirë ndërkombëtare.

Megjithëse jo shumë mirë të njohura, nismat dhe përvojat e ndryshme të drejtësisë tranzicionale në vendet e rajonit duhet të shërbejnë si bazament për diskutime në Kosovë gjatë vendosjes së mekanizmave për t'u marrë me të kaluarën. Megjithëse Kosova është e veçantë, prapë se prapë mund të merr disa mësim të rëndësishme – si pozitive ashtu edhe negative – nga vendet fqinje që i tejkalojnë trumat kombëtare të tyre.

3. Historiku i konfliktit në Kosovë

Në vazhdim është historiku më i zakonshëm i konfliktit në Kosovë. Sidoqoftë, edhe ky historik mund të kundërshtohet nga palët e përfshira.

Pas një historie të gjatë të luftës për barazi nën sundimin serb, kushtetuta jugosllave e vitit 1974 i dha Kosovës autoritet të plotë juridik mbi territorin e saj, duke ia ngritur statusin nga një krahinë autonome brenda Serbisë në afërsisht status të njëjtë me 6 republikat tjera të federatës²⁹. Kushtetuta i dha Kosovës përfaqësim të drejtpërdrejtë dhe të barabartë në të gjitha organet vendim-marrëse, me të drejtë të vetos. Nuk mund të merrej asnjë vendim në nivelin federal apo atë të Serbisë pa pajtimin e Kosovës. Gjithashtu, ajo i garantonte Kosovës të drejtën në kushtetutën e saj, që krijoi të gjitha institucionet e nevojshme dhe legjitime, përfshirë edhe kuvendin, qeverinë, gjyqësinë dhe policinë. Statusi i republikës, megjithatë, kurrë nuk iu ishte dhënë Kosovës.

Pavarësisht nga këto ndryshime, mospërfillja ekonomike e federatës për Kosovën vazhdoi përgjatë dekadave të ardhshme siç vazhdoi trajtimi i shqiptarëve të Kosovës si qytetarë të dorës së dytë³⁰. Kjo ndihmoi në rritjen e kërkesës për republikë të plotë. Më 1981, ajo që

²⁹ Malcolm, Noel. Kosova: Histori e shkurtë. Papermac, Londër. f. 314-333 (1998); Judah, Tim. Kosova: Lufta dhe hakmarra. Botimi i 2-të. Yale University Press, New Heaven, f. 38 (2002).

³⁰ Komisioni i Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (KPNK). Raporti për Kosovën: Konflikti, përgjigja ndërkombëtare, mësimet e marra. Oxford University Press, Oxford., f 37 (2000).

filloi si protesta të studentëve për kushte më të mira në universitetin e Prishtinës shpejt u kthye në demonstrata të mëdha përgjatë gjithë Kosovës me kërkesat për barazi, përmirësim të kushteve ekonomike dhe për Kosovën Republikë³¹. Forcat policore serbe i shuan demonstratat me dhunë dhe brutalitet, që sollën një numër të paqartë të vdekjeve³². Në këtë pikë, polarizimi mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë u rrit. Këto ngjarje mbetën simbol i refuzimit të qartë të sundimit serb nga ana e shqiptarëve të Kosovës, e që prej atëherë filloi të rritej gjithnjë e më shumë.

Gjatë viteve të '80-ta Slllobodan Millosheviqi filloi të ngjitej në pushtet dhe më 1989 kur u bë kryetar i Serbisë një nga masat e tij për shfuqizimin e statusit autonom të Kosovës rezultoi me anulimin jo-kushtetues të autonomisë së Kosovës në mars të vitit 1989 dhe vendosjen e asaj që ishte provuar nga shumica e popullatës si një regjim apartheidi. Nga 1989 e deri më 1991, Serbia në mënyrë sistematike i shtypi shqiptarët e Kosovës dhe suspendoi institucionet e saja, i ndërpreu sistemin e arsimit dhe shëndetësisë dhe largoi rreth 150,000 shqiptarë nga puna në polici, arsim, ndërmarrjet shtetërore etj³³. Kjo çoi në ndërtimin e qeverisë paralele të organizuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e të ndjerit kryetarit Ibrahim Rugova. Për dallim prej kombeve tjera të ish Jugosllavisë, shqiptarët e zgjodhën rrugën e rezistencës së pa dhunshme dhe zgjidhjen paqësore të konfliktit. Kjo pozitë u shikua me admirim nga shtetet perëndimore të cilat megjithatë dështuan ta shfrytëzojnë këtë mundësi për të zgjidhur problemin e Kosovës.

Më 1995, vendimi për mos përfshirjen e çështjes së Kosovës në bisedimet e Dejtonit lëkundën stabilitetin e LDK-së. Zhgënjimi i thellë i shqiptarëve të Kosovës të organizuar përrreth lëvizjeve majtiste, siç ishin Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) dhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), filluan forcimin e një rryme të re të rezistencës, që u bë e njohur si Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Shumë shqiptarë tashmë ishin të sigurt se rezistenca e bashkuar paqësore nuk do të sillte lirinë dhe që veprimi ushtarak ishte mundësia e vetme³⁴. Përveç kësaj, UÇK gjithashtu kishte për qëllim të përmbysë LDK-në, duke e akuzuar shpesh Rugovën si tradhtar.

Më 1997 dhe 1998 UÇK-ja filloi sulmet e organizuara kundër forcave policore serbe në Kosovën qendrore. Luftimet me policinë u shtuan dhe u përhapën në tërë vendin sapa serbët filluan sulmet vdekjeprurëse kundër fshatrave shqiptare, duke kryer mizori mbi civilët gjersa mundoheshin të zënë luftëtarët e UÇK-së³⁵. Në paralel me LPK-në dhe LKÇK-në vepronte UÇK, ndërsa “qeveria në mërgim” e LDK-së organizoi Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK). Që të dy krahët ushtarak ndërmerrnin veprime kundër policisë dhe forcave ushtarake Serbe, mirëpo ndesheshin edhe midis njëra tjetrës, veçanërisht në pjesën perëndimore të Kosovës – rajonin e Dukagjinit. Për më tepër, vrasja e pasqaruar e Kolonelit Ahmet Krasniqi, Ministrit të Mbrojtjes së Qeverisë në Mërgim të udhëhequr nga LDK më 21 shtator 1989 në Tiranë, dhe tentim vrasja e pasuksesshme e Sabri Hamitit, Zyrtarit të lartë të LDK, tri ditë më vonë, ka përshkallëzuar më tutje marrëdhëniet dhe mosbesimin midis LDK-së dhe UÇK-së.

³¹ Malcolm, op.cit., f. 334-336.

³² Malcolm-i pajtohet që numri i vdekjeve ka shkuar në qindra. Po aty., f. 335.

³³ Malcolm, op.cit., f. 349.

³⁴ Blumi, Isa. Kufijtë etnik në Shoqërinë Demokratike të Kosovës: Karta identifikuese e KB-së, f. 224-226. Në: Bieber, Florian dhe Daskalovski, Zidas (Eds.), Të kuptuarit e luftës në Kosovë, Londër: Frank Cass, (2003).

³⁵ Judah, op.cit., f. 139-140.

Më 29 janar të vitit 1999, Grupi i Kontaktit vendosi të organizojë një Konferencë Paqe për Kosovën, e cila duhej të fillonte më 6 shkurt të vitit 1999 në Rambouillet (Francë). Pas negociatave të mundimshme, më 23 shkurt të vitit 1999, delegacioni shqiptar i Kosovës në parim miratoi Marrëveshjen e Paqes pas letrës së garancisë nga Sekretarja e Shtetit të SHBA, zonjës Albright, se pas tri viteve të zgjedhjes së përkohshme në Kosovë do të mund të mbahet referendumi për statusin përfundimtar. Sidoqoftë, marrëveshja mbeti të nënshkruhet pas dy javësh në Paris, pasi të jenë përfunduar konsultimet me strukturat komanduese të UÇK-së.

Si pasojë, më 19 mars të vitit 1999, në Paris u nënshkrua Marrëveshja për Paqe nga delegacioni i shqiptarëve të Kosovës. Në anën tjetër, marrëveshja nuk u miratua dhe nuk u nënshkrua nga përfaqësuesit Jugosllavë/Serbë. Për më tepër, përpjekjet e të dërguarit të atëhershëm të SHBA, z. Richard Holbrook për të arritur një ujdi me z. Millosheviq përfundimisht dështuan më 23 mars të vitit 1999. Menjëherë pastaj Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i asaj kohe, z. Javier Solana, urdhëroi sulmet e NATO-s kundër Jugosllavisë, të cilat filluan më 24 mars të vitit 1999.

Në javët e para të fushatës ajrore të NATO-s situata në Kosovë ndryshoi në mënyrë dramatike. Më shumë se 850,000 Shqiptarë u detyruan të lëshojnë Kosovën, përderisa gati gjysmë milioni sosh ishin të zhvendosur përbrenda Kosovës. Serbia praktikisht bëri spastrim etnik të Kosovës. UÇK nuk ishte në gjendje të mbronte popullatën. Për më tepër, për shkak të mungesës së ushqimit dhe strehimit për të zhvendosurit. Ndërkohë, vrasjet masive nga forcat Serbe ndodhnin në baza ditore, me një mesatare prej 250 viktimize në ditë, duke e ngritur numrin e të vrarëve në më shumë se 10,000 persona.³⁶

Sulmet ajrore të NATO-s mbi Serbinë zgjatën 78 ditë, deri më 9 qershor 1999, kur Millosheviqi u dorëzua dhe i tërhoqi të gjitha trupat serbe³⁷. Po atë ditë, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1244, duke vendosur protektoratin ndërkombëtar mbi Kosovën.

Gjatë vitit 1999-2000, gjersa u vendos rendi dhe KFOR-i i udhëhequr nga NATO organizoi

Gjatë luftës më shumë se 10,000 shqiptarë u vranë dhe 850,000 u detyruan të lëshojnë Kosovën. Në periudhën 1999-2000 një numër i madh i serbëve të Kosovës dhe të bashkësisë RAE u bënë viktima të veprimeve hakmarrëse

çarmatimin e UÇK-së një numër i madh i serbëve të Kosovës si dhe bashkësia e Romëve, Ashkalijve dhe Egjiptianëve (RAE) u bënë viktima të veprimeve hakmarrëse si vrasjeve, dëbimeve, ngacmimeve brutale dhe diskriminimit nga ana e shqiptarëve të Kosovës.³⁸ Në pjesën e dytë të qershorit të vitit 1999, shkalla e vrasjeve në Kosovë e arriti nivelin e 50 vrasjesh për javë.³⁹

Kjo përbënte një dështim të konsiderueshëm i cili

komplikohej më tutje nga fakti se minoriteti Serb shikohej si cak për hakmarrje në një përmasë të madhe dhe se KFOR-i ka dështuar të parandalojë Beogradin nga realizimi i ndarjes së Mitrovicës përgjatë lumit Ibër. Megjithatë, në fillim të vitit 2000 numri i vrasjeve

³⁶ Institutit për Raportimin e Luftës dhe Paqes (IRLP). Loja me numra në Kosovë. Raporti për Krizën Ballkanike Nr. 92. (12.11.1999)

³⁷ Clark, Wesley K. (Gjeneral). Drejtimi i Luftës Moderne: Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, dhe e ardhmja e dyliftimit. Botimi i 1-rë. Public Affair, SHBA, f. 173-195, 347-369 (2001).

³⁸ Kramer, Helmut dhe Džihic, Vedran. Die Kosovo-Bilanz: Scheitert die internationale Gemeinschaft?. LIT Verlag, Wien, f. 37 (2005).

³⁹ Lord Robertson nga Port Ellen, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Kosova një vit pas: të Arriturat dhe Sfidat, f.16, 21 mars 2001, <http://www.nato.int/kosovo/repo2000/index.html>.

ra në 5 për javë,⁴⁰ pasi që më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të trupave të angazhuara të NATO-s ishin përfshirë në mbrojtjen e Serbëve dhe pakicave tjera.⁴¹ Midis 60,000 – 220,000 serbë të Kosovës lëshuan Kosovën apo u dëbuan nga Kosova gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999.

Që nga periudha 2001-2004 kishte relaksim gradual dhe, përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike. Serbët e Kosovës morën pjesë në zgjedhje të përgjithshme të vitit 2001 dhe në zgjedhjet komunale të vitit 2002. Mirëpo kjo nuk u përkthye në veprime konkrete për tejkalimin e ndasive midis Shqiptarëve dhe Serbëve. Përfaqësuesit e Serbëve të Kosovës në Kuvendin e Kosovës u bënë më shumë dorë e zgjatur politike e qeverisë së re demokratike të Beogradit se sa një fuqi politike e cila përpiqej të zgjidhte çështjet e Serbëve të Kosovës. Në ndërkohë, Serbia vazhdonte të financonte institucionet paralele të shëndetësisë, arsimit, pensioneve, asistencës sociale, gjykatave paralele në hapësirat e banuara me serbë në Kosovë, duke përfshirë edhe zyrat e Ministrisë së sajë të Punëve të Brendshme (MPB) në lëshimin e dokumenteve personale dhe atyre të udhëtimit.

Përmirësimi gradual i marrëdhënieve ndëretnike shënoi kolaps në mars të vitit 2004, kur gjatë trazirave të 17 dhe 18 marsit të vitit 2004, ku protestuesit shqiptarë të Kosovës sulmuan serbët e Kosovës duke lënë 19 të vdekur (11 shqiptarë dhe 8 serb), shkaktuan djegien e pronës dhe monumenteve religjioze serbe në pjesën më të madhe të Kosovës dhe zhvendosjen e më se 4,000 serbëve dhe romëve.⁴² Kjo i dha fund pjesëmarrjes së shprehur të serbëve në institucionet e Kosovës dhe përforcoi kontrollin e Serbisë në çështjet e Serbëve të Kosovës.

Në sferën politike, kjo e shtyri bashkësinë ndërkombëtare të shpejtojë procesin e gjetjes së zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Bisedimet për statusin final të ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare mes Kosovës e Serbisë filluan më 2006, nën udhëheqje të ish Kryetarit Finlandez Marti Ahtisaari. Bisedimet për statusin përfundimtar vazhduan deri në nëntor 2007. Bisedimet nuk dhanë rezultat dhe përfundimi kryesor ishte Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaari-t për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës që përfshin nivelin më të lartë të mbrojtjes për komunitetin serb, dhe i cili i dha Kosovës një pavarësi të “mbikëqyrur ndërkombëtarisht”. Në shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës e miratoi deklaratën e pavarësisë, por me kundërshtimin e fortë të serbëve të Kosovës dhe veçanërisht të Serbisë.

4. Drejtësia tranzicionale në Kosovë

Në Kosovë, paqja konsiderohet e arritur e qëndrueshme sado e brishtë që mund të jetë. Drejtësia në anën tjetër, shumë thellë varet nga të kuptuarit e individit dhe grupeve etnike saqë paraqet pikërisht kërcënim për paqen e brishtë. Çka konsiderohet drejtësi tani më 2008, pas shpalljes së pavarësisë, mund të ndryshojë nga ajo që kemi konsideruar drejtësi më 1999. Gjersa për shumicën, pavarësia kuptohet si drejtësi përfundimtare e me këtë largohen të gjitha kërcënimet (p.sh. që ata përsëri do të vihen nën sundimin e Serbisë), për serbët e Kosovës mund të paraqet përtëritje të kërcënimeve (p.sh. që ata do të bëhen viktima të hakmarrjes)⁴³.

Rrethanat politike të pasluftës nuk adresuan arritjen e drejtësisë

⁴⁰ Ibid.

⁴¹ <http://www.nato.int/facts/2000/kosovo.html>

⁴² UNHCR. Serbia dhe Mali i Zi: Kosovë.

⁴³ Grup i Fokusit. Mars 2008.

Përfundimi i luftës në Kosovë me intervenimin ndërkombëtar ndikoi në ndarjen e qartë të fituesve dhe humbësve të konfliktit⁴⁴. Pas luftës të vitit 1999, pasi që sektori i drejtësisë dhe i sigurisë si dhe struktura institucionale praktikisht nuk ekzistonin, misioni i KB-ve ishte përgjegjës për krijimin dhe mbledhjen e strukturave mjeteve urgjente të brendshme. Situata politike që u vendos pas luftës, nuk iu drejtua faktorit të drejtësisë, nuk iu drejtua shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe një numri të madh të çështjeve të ndjeshme përfshirë edhe personat e zhdukur. Siç pajtohen shumë ekspertë vendorë, drejtësia u flijua për të mirën e qëndrueshmërisë⁴⁵. Këto i bëjnë kushtet e Kosovës më të vështira në sferën e ballafaqimit me të kaluarën dhe e bëri Kosovën vend të “ndarë etnikisht dhe me popullatë pakicë të grumbulluar bashkë politikisht dhe gjeografikisht”⁴⁶.

Nismat e ndryshme për adresimin e së kaluarës duket të gëzojnë nivel të ulët të njohurisë në popullatë. Së pari, dialogu mes etnive pengohet nga urrejtja dhe mosbesimi dhjetëvjeçar ndëretnik. Përgjithësisht nga pakica serbe dhe pjesërisht nga administrata ndërkombëtare besohet se shqiptarët e Kosovës nuk mund të gjykojnë drejtë dhe në

mënyrë të paanshme krimet ndëretnike⁴⁷. Së dyti, shoqëria në përgjithësi dukshëm beson që shkeljet e të drejtave të njeriut, padrejtësitë dhe dialogu nuk do të adresohen asnjëherë. Me të vërtetë ka mungesë të informatave, diskutimit dhe dialogut për të kaluarën, jo vetëm në shoqëri në përgjithësi por edhe në mes të vet shqiptarëve të Kosovës. Deri më tani nuk ka pasur diskutim publik për gjykimet që janë bërë për rastet e krimeve të luftës dhe shkeljeve masive të të drejtave të njeriut para, gjatë apo pas luftës më 1999.

Gjithashtu, ka dalë në pah një mendim tjetër i dëmshëm në lidhje me të drejtën ekskluzive të secilit grup etnik të madh për tu konsideruar si viktimë. Kur janë pyetur se a kanë bërë krime lufte pjesëtarët e grupeve të tyre, 78% të shqiptarëve të Kosovës e refuzojnë këtë pohim⁴⁸. Siç është rasti me vendet post-konfliktuale të ish-Jugosllavisë, e kaluara nuk ballafaqohet hapur me përfshirjen e hetimit të shtetit dhe vlerësimeve personale të konfliktit⁴⁹. Të tjera ngjashmëri mes Kosovës dhe vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë përfshijnë “gjykimet vendore për krime të luftës kanë dështuar të adresojnë shkallën e mizorive dhe gjykatat kanë dështuar të ofrojnë drejtësinë e paanshme për të dyshuarit për krime lufte në jurisdikcionin e tyre pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe kombëtare.”⁵⁰

⁴⁴ Agon Vrenezi. Intervistë. Shkurt 2008

⁴⁵ Grup i Fokusit. 12 mars 2008.

⁴⁶ Hehir, Aidan. Ndërtimi i Krahinës Autonome. Teoria identifikuese dhe dështimi I UNMIK-ut. Paqëruajtja ndërkombëtare, Vol.13, Nr.2, f. 200-213 (qershor 2006).

⁴⁷ Përgjigjja e qeverisë së Kosovës për deklaratën e ish kryeprokurores të GJPNJ -së Del Ponte për trafikimin masiv të organeve të serbëve nga luftëtarët shqiptarë të Kosovës më 1999 nuk ishte bërë në këtë aspekt për të siguruar pakicën serbe dhe bashkësinë ndërkombëtare. Në të vërtetë, Hajredin Kuçi, zëvendëskryeministër deklaroi se: “e kemi çështje më të rëndësishme për tu marrë sesa me shpifje të këtilla”. Citat nga BalkanInsight, KB: Asnjë dëshmi për Trafikimin e Organeve në Kosovë, 16 prill 2008, marrë nga <http://balkaninsight.com/en/main/news/9441>.

⁴⁸ Raport i UNDP-së, op.cit., f. 16.

⁴⁹ Rangelov, Iavor. Hyrja në BE, kushtet dhe drejtësia kalimtare në ish-Jugosllavi, LSE

⁵⁰ Ibid.

4.1. Palët kryesore të interesit dhe politikat

Që nga viti 1999, përgjegjësia për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera në Kosovë gjatë dhe pas luftës janë adresuar nga shumë palë. Nivelet në të cilat këto shkelje u adresuan ndryshojnë në një masë të madhe në mes të institucioneve të ndryshme. Prania e më shumë se një pjese të përgjegjësive shpesh ka rezultuar në gjuajtjen e fajit te tjetri. Shpesh dallimi mes vendorëve dhe ndërkombëtarëve është shkaktuar nga shtresat e pazakonshme të pushtetit, përgjegjësive si dhe ekspertizës. Kjo me siguri ka reflektuar në mendimin e publikut për paaftësinë e kryerjes së punës ashtu si duhet si të njërit po ashtu edhe të tjetrit duke krijuar në këtë mënyrë pakënaqësi të përgjithshme. Ky mendim negativ është acaruar me mungesën e debatit publik dhe informacionit për punën të palëve të ndryshme në fushën e kërkimit të së vërtetës dhe përgjegjësive për shkeljet e të drejtave të njeriut.

4.1.1. Palët ndërkombëtare të interesit

a) Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë

GJPNJ-ja ishte themeluar më 1993 me rezolutën 827 të KB-së the paraqet një ndër mekanizmat më të rëndësishëm për drejtësinë tranzicionale në vendet e ish-Jugosllavisë. Mandati i saj është të sjellë para drejtësisë personat përgjegjës për shkelje serioze të drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë⁵¹. Të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë janë të detyruara të bashkëpunojnë me GJPNJ-në dhe duhet të mbledhin dhe mbajnë dëshmitë si dhe të arrestojnë dhe burgosin të dyshuarit për krime lufte⁵². Pas deklarimit të “kompletimit të fazës” së saj nga Këshilli i Sigurimit i KB-ve pas më shumë se 10 viteve të themelimit të saj, një numër i gjykimeve të rëndësishme do të mbesin pa u zgjidhur⁵³. Kjo bindje forcohet nga besimi i gjerë se pak parakushte për ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe gjykime janë bërë në vendet e ish-Jugosllavisë për të mundësuar përfundimin e këtyre rasteve që me siguri do të “ushqejnë kulturën e mos ndëshkueshmërisë”⁵⁴. Në Kosovë, vetëm serbët e Kosovës besojnë deri në 56% se gjykimet për krime të luftës në GJPNJ ndihmojnë në arritjen e drejtësisë, gjersa shqiptarët e Kosovës dhe bashkësitë e tjera jo-shumicë mendojnë se gjykimet për krime lufte të kryera në Kosovë do të ndihmojnë më shumë në arritjen e drejtësisë⁵⁵. Ky mos-besim në punën e GJPNJ-së përkrahet nga shumë shqiptarë të Kosovës që e shohin padinë e GJPNJ-së ndaj dy ish pjesëtarëve të UÇK-së (nga shtatë të akuzuar) një përpjekje tronditëse për të barazuar rolin e palëve të përfshira në luftë në Kosovë e me këtë barazimin e viktimës me autorët e krimit. Për pjesën më të madhe të shqiptarëve të Kosovës, “ E vërteta e hidhur mbetet se edhe pas dhjetë viteve të luftës Gjykata e Hagës, deri më tani, ka dënuar dy shqiptarë dhe asnjë serb”⁵⁶. Kjo tregon ndjenjën e përgjithshme midis shqiptarëve të Kosovës të mos-efikasitetit në njërin anë dhe të njëanshmërisë në anën tjetër të GJPNJ-së⁵⁷.

⁵¹ Për më shumë informacione për mandatin dhe rastet shih: www.un.org/icty.

⁵² Zupan

⁵³ P.sh. Ratko Mladic dhe Goran Hadzic që ende gjenden në liri.

⁵⁴ Zupan. Op.cit.

⁵⁵ Raport i UNDP-së, f. 22.

⁵⁶ Palokaj, Augustin. ‘Drejtësia e Del Pontes’. Koha Ditore. 7 prill 2008, f. 10.

⁵⁷ Një numër i serbëve janë paditur për krime të kryera në Kosovë edhe pse asnjëri prej tyre nuk janë serbë të Kosovës.

Gjykimi më i njohur në GJPNJ ishte rasti i ish kryetarit Sllobodan Millosheviqi që pat filluar më 2001. Kur Sllobodan Millosheviqi vdiq në qelinë e tij më 2006, gjykimi i tij përfundoi pa aktgjykim duke e lënë të kaluarën e tij të luftës pa u ndëshkuar. Siç e formulon analisti i njohur i Ballkanit Tim Xhuda: “Nuk do të ketë kurrë aktgjykim nga jashtë për rajonin, që ish-jugosllavët do të mund t’i referoheshin ndonjëherë si të pavarur”⁵⁸. Gjykimi i ish kryetarit Sllobodan Millosheviq pati raportim masiv në tërë Kosovën dhe vdekja e tij pa aktgjykim ishte zhgënjyese për shumë vetë. Në anën tjetër, ish kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, një ish komandant i UÇK-së, ishte ngarkuar për krime lufte nga Gjykata e Hagës në mars të vitit 2005. Padija ndaj tij ishte kritikuar ashpër nga shqiptarët e Kosovës. Megjithatë në prill të vitit 2008, pas gjykimit që zgjati tri vite, Haradinaj u shpall i pafajshëm dhe u lirua nga Gjykata e Hagës⁵⁹. Shqiptarët e Kosovës e festuan lirinë e tij si një dëshmi e fundit se lufta e shqiptarëve ishte e drejtë. Mendimi në anën serbe për këtë ishte ai i drejtësisë partizane.

b) UNMIK-u

Menjëherë pas luftës në vitin 1999, krijimi i sistemit gjyqësor funksional ishte një ndër sfidat vendimtare për misionin e KB-ve. Siç është përmendur me të drejtë, “dështimi për tu marrë me të kaluarën dhe shkeljet e vazhdueshme aty për aty dhe me efikasitet dhe për të krijuar

Vendosja e protektoratit të KB-ve nuk ka mundur të pengojë kaosin në një vend ku organet e drejtësisë dhe të policisë e lëshuan vendin bashkë me regjimin.

një ndjenjë të rendit dhe ligjit, mund të pengojnë qëllimet e përgjithshme të funksionimit”⁶⁰. Në fakt, siç është vërtetuar nga shumë organizata ndërkombëtare si dhe palë vendore të interesit në tetë vitet e fundit, kjo saktësisht është ajo çka ka ndodhur në Kosovë. Vendosja e protektoratit të KB-ve nuk ka mundur të pengojë kaosin në një vend ku organet e drejtësisë dhe të policisë e lëshuan vendin bashkë me regjimin. Siç e ka vlerësuar Sekretari i Përgjithshëm në raportin e tij para Këshillit të Sigurimit në korrik të vitit 1999 “ Problemi i sigurisë në Kosovë në një masë të madhe është rezultat i mungesës së institucioneve dhe agjencive të rendit dhe ligjit. Shumë krime dhe padrejtësi nuk mund të ndiqen në mënyrë të duhur.”⁶¹

UNMIK-u kishte mandat të krijonte sistemin e ri emergjent të gjyqësorit, zhvillimin e tij në gjyqësor funksional dhe të mbikëqyrë pavarësinë e tij. Po ashtu, OSBE-ja kishte për detyrë në bazë të mandatit të ndërtojë institucionet juridike dhe të monitorojë sistemin e drejtësisë⁶². UNMIK-u po ashtu themeloi Zyrën Mjeko-ligjore për Persona të Zhdukur (ZMPZH), brenda shtyllës së saj të I-rë të policisë dhe drejtësisë për të ndihmuar me ekspertizë në kontrollimin e mbetjeve të trupave të pajetë.

⁵⁸ Xhuda, Tim. Mospërputhja e trashëgimisë së Miloseviqit. BBC. 11 mars 2006. Marrë nga: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4797564.stm>.

⁵⁹ Duhet të përmendet deklarata e gjyqtarit kryesor që “Trupi gjykues fitoi përshtypje të fortë që gjykimi ishte duke u mbajtur në një atmosferë ku dëshmitarët ndihen të pa sigurt”. Shih <http://www.un.org/icty/pressreal/2008/pr1232e-summary.htm>

⁶⁰ Strohmeyer, Hansjörg. Kolapsi dhe Rindërtimi i Sistemit Gjyqësor: Misionet e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Timorin Lindor. Gazeta amerikane e së drejtës ndërkombëtare, Vol. 95, Nr. 1, f. 46-63 (2001)

⁶¹ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm para Këshillit të Sigurimit “ Mbi Misionin e Administratës së Përkohshme në Kosovë”, S/1999/779 më 12 korrik, 1999 i cituar në raportin e Amnesty International “Kosova (Serbia): Sfidat e rregullimit të sistemit të dështuar të KB-ve” janar 2008.

⁶² Instituti Gjyqësor i Kosovës që ka trajnuar gjyqtarë dhe prokurorë fillimisht ishte organ i ndihmuar nga OSBE-ja e që u bë institucion i pavarur vetëm në vitin 2005.

Pas një kohe të mandatit, burgjet u tej ngarkuan me të burgosur serbë që kundërshtonin paraburgimet e gjata pa gjykim. GJPNJ-ja mund të gjykonte vetëm rastet për kriminelët të paditur për mizoritë e mëdha në shkallë të gjerë. Ideja e themelimit të Gjykatës për Krimet Etnike të Luftës në Kosovë (GJKLEK) të udhëhequr ndërkombëtarisht si një dorë vendore e GJPNJ-së ishte braktisur pas disa muajve për shkak të qëndresës nga avokatët dhe gjyqtarët shqiptarë të Kosovës që i frikoheshin mungesës së zotërimit të gjykatës së ardhshme si dhe ndërlikimeve me rastin e një shtrese shtesë në mes të sistemit gjyqësor vendor dhe GJPNJ-së⁶³. Menjëherë pas kësaj, UNMIK-u shpalli rregulloren 2000/6⁶⁴ dhe emëroi prokurorin dhe gjykatësin e parë ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë pas një incidenti të dhunshëm ku një gjyqtar shqiptar i Kosovës liroi kriminelët e dyshuar⁶⁵. Pas thirrjeve të vazhdueshme të për vëmendje nga ana e serbëve të Kosovës për shkak të paraburgimeve të stërzgjatura dhe nga Seksioni për Monitorimin e Sistemit Ligjor (SMSL) për përpjekje të shtuara për objektivitet ku gjykimet një-etnike të përbëra dhe udhëhequra nga shqiptarët e Kosovës, UNMIK-u e rriti praninë e gjyqtarëve dhe Prokurorëve ndërkombëtarë (GJPN) në komisione për të parandaluar shqiptarët e Kosovës nga mbivotimi i tyre në rastet e krimeve të luftës⁶⁶. Megjithatë, numri i maksimum tetë GJPN-ve që shërbenin në Kosovë ishte jashtëzakonisht i vogël për tu përballur me numrin e madh të rasteve dhe mandatit afatshkurtër të tyre prej gjashtë (6) muajsh nuk u ndihmoi homologëve të tyre vendorë.

Edhe pas nëntë viteve pasi që u konstatua duket se akoma mbetet vlerësimi se UNMIK-u “ dështoi të zhvillojë një strategji koherente për sektorin e drejtësisë, përfshirë edhe rastet për krime lufte. Ai zgjodhi në vend të saj një qasje të ndruajtur që u provua katastrofike për të dy si mbrojtësit ashtu dhe viktimat, e në veçanti të serbëve të Kosovës”⁶⁷. Në anën tjetër, pas gati një dekadë pas rithemelimit të sistemit gjyqësor vendor, për shkak të [gjoja] paragjykimëve në baza etnike në gjyqësi, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut e shihnte sistemin gjyqësor të Kosovës të paaftë të merret me krimet e luftës dhe krimet ndëretnike⁶⁸. Megjithatë, disa palë të interesit në Kosovë e hedhin poshtë këtë, duke e arsyetuar se qasja ndërkombëtare është influencuar nga paragjykimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, për shkak të mungesës së kontakteve profesionale me homologët e tyre vendorë e që fatkeqësisht do të transferoj këtë qasje të gabuar edhe në misionin e BE për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX). Gjithashtu, pavarësia e sektorit të gjyqësisë të UNMIK-ut është vënë në pikëpyetje gjatë tetë viteve të fundit nga shumë raporte duke e

⁶³ Periello, Tom dhe Wierda, Marieke. GJNKJ: Mësimet nga dërgimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në Kosovë. Mars 2006.

⁶⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 e 15 shkurtit 2000 për Emërimin dhe Shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtarë:

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2000regs/RE2000_06.htm

⁶⁵ Ibid.

⁶⁶ Hartmann, Michael. Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë në Kosovë: Modeli i ri për ruajtjen e paqes të pas konfliktit. 2003; Kjo rregullohet me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/64 për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe Rregulloren Nr. 2001/2 duke e ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/6, ashtu si e ndryshuar, për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë.

⁶⁷ Marshall, David dhe Inglis, Shelley. Shfuqizimi i të drejtave të njeriut të bazuar në drejtësi në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Harvard Human Rights Journal, f. 101 (pranverë 2003). Shih po ashtu Amnesty International, Serbia (Kosovë): Sfidat e rregullimit të misionit të dështuar të drejtësisë (janar 2008), marrë nga <http://www.amnesty.org/en/library/asset/EUR70/001/2008/en/EUR700012008en.html>.

⁶⁸ Zëri i Amerikës, Intervista me Kryesuesin e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut Robert Dean në artikullin ‘Gjyqësori i përgatitur për statusin e ri’ publikuar në Infopress më 14 janar 2008.

arsyetuar se duke qenë subjekt i dorës ekzekutive të Administratës së UNMIK-ut, përfundimisht i ka njoollsur Programin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë⁶⁹.

Nga fundi i vitit 2008 pritet që një numër gjyqtarësh dhe prokurorësh ndërkombëtarë nga BE-ja ta zëvendësojnë Misionin e OKB-së në Kosovë. Kjo do të kërkojë një tjetër periudhë kalimtare deri sa gjyqtarët dhe prokurorët e rinj të familjarizohen me situatën politike dhe rastet gjyqësore. Sipas Ushtruesit të Detyrës së Kryesuesit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, i cituar në raportin e Amnesty International të vitit 2008, rastet e papërfunduara të tetë viteve të fundit të administrimit të sistemit të gjyqësisë nga UNMIK-u do të duhen të adresohen nga Misioni Evropian për Siguri dhe Politikë Mbrojtëse⁷⁰.

c) EULEX-i

Misioni i BE për sundimin e ligjit në Kosovë EULEX ka mandatin për “kthimin mbrapsht apo anulimin e vendimeve operationale të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës”, “të sigurojnë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike, krimeve financiare/ekonomike, dhe krimeve tjera serioze do të hetohen, ndjekën, gjykohen dhe zbatohen në mënyrë të duhur në përputhje e ligjin.”⁷¹ Më në veçanti, përderisa EULEX do të monitorojë, mbikëqyr dhe këshillojë institucionet Kosovare për sundimin e ligjit, ajo ka të rezervuar domenin lidhur me rastet e krimeve të luftës, krimeve ndëretnike, e cila e bën atë njërin ndër institucionet kyçe me të drejtën për të siguruar zbatimin e të drejtës tranzicionale në Kosovë.

Më 6 prill të vitit 2009, misioni i BE për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX) shpalli se është plotësisht operacional në Kosovë, katër muaj pasi filloi fazën e saj operationale nën kornizën e mandatar nga KS i OKB për “status neutral”. Fillimisht ky mision ishte planifikuar të ketë në vete rreth 2,000 gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë policor dhe doganierë ndërkombëtar. Për shkak të zhvillimeve politike në Kosovë por edhe në rajon, e veçanërisht për shkak të rënies globale financiare, “kapaciteti i plotë operacional” përfundimtar përmban 1,710 të punësuar ndërkombëtarë, me një tendencë zbritjeje.

Struktura momentale e të punësuarve të EULEX-it është e strukturuar në mënyrë të papërshtatshme. Misioni numëron rreth 1,300 zyrtarë policorë, të cilët përfaqësojnë shumicën absolute e rreth 1,700 të punësuarve ndërkombëtarë. Sipas kësaj skeme, nga të gjitha institucionet e sundimit të ligjit, ka një mospërfillje tepër të lartë për prokurorinë dhe gjykatat, ku BE ka sjellë në Kosovë vetëm rreth 20 prokurorë dhe 40 gjykatës.

Si pasojë e mosefikasitetit të UNMIK-ut, rreth 500 raste, prej të cilave rreth 150 raste penale, kanë mbetur të pazgjedhura me vite të tëra. Këto raste tani iu kanë transferuar EULEX-it dhe, sipas zyrtarëve të BE-së, janë në një gjendje më të keqe të mundshme sipas çfarëdo standardesh profesionale, dhe janë pasojë dhe tregues i qartë i mosaftësisë së UNMIK-ut për të kryer punën e tij.⁷² Një shembull tjetër i qartë i mosaftësisë së tyre është fakti se mesatarja e punës së një gjyqtari të UNMIK-ut është 1.5 raste për vit.⁷³

⁶⁹ Amnesty International. “Kosova (Serbia): Sfidat e rregullimit të misionit të dështuar të drejtësisë të KB-ve”, janar 2008, f. 36-37.

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Plani i përbashkët për veprim i Këshillit të Bashkimit Evropian, 2008/124/CFSP

⁷² Intervistat personale me një zyrtar të BE-së dhe dy zyrtarë të EULEX-it, mars/prill 2009.

⁷³ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të EULEX-it, shtator 2008.

Përkundër faktit se gjyqësori i Kosovës shihet si pjesa më e korruptuar e zinxhirit të institucioneve të sundimit të ligjit, e tërë komponenti i Drejtësisë i misionit përbën vetëm 10% të kapacitetit të plotë të EULEX-it. Për më tepër, një pjesë e madhe e personelit të EULEX-it janë njerëz të cilët paraprakisht kishin punuar për UNMIK-un. Lidhur me këtë, ish udhëheqësi Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut tani është personi kyç në komponentin e Drejtësisë të EULEX-it, përdërisa rreth 15% të të punësuarve të tanishëm të EULEX-it kanë punuar për UNMIK-un deri në ditën kur EULEX-i u bë operacional, më 9 dhjetor 2008.⁷⁴

Do të mbetet sfida për EULEX-in se cilat ligje do të aplikojnë gjyqtarët dhe prokurorët e sajë, duke marrë në konsiderim “neutralitetin e saj ndaj statusit”, të cilat do të ndikojnë në pranimin e komponentit të drejtësisë tranzicionale të misionit nga popullata.

4.1.2. Palët vendore të interesit

a) Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës nuk ka qenë aktiv në çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzicionale. E vetmja çështje që është trajtuar në Kuvend është ajo e personave të zhdukur. Kjo çështje mbulohet në bazë të mandatit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazisë

Kuvendi i Kosovës nuk ka treguar interesim në çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë kalimtare

Gjinore, Personave të Zhdukur dhe Peticioneve. Gjatë viteve të fundit Komisioni vazhdimisht ka bërë thirrje për më shumë përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës. Megjithatë ata nuk kanë zhvilluar ndonjë strategji apo ndërmarrë ndonjë masë të veçantë për të hapur debatin në Kuvend për

çështjen e personave të zhdukur. Kërkesa e fundit e tillë ka të bëjë me funksionalizimin e Komisionit të Qeverisë për Persona të Zhdukur⁷⁵. Veç kësaj, çështjet e të kthyerve dhe bashkësive po ashtu adresohen përmes Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive dhe të të Kthyerve. Deri më tani ky Komision nuk ka kërkuar asnjë raport nga dega e ekzekutivit sa i përket përparimit dhe strategjisë për të kthyerit dhe ri-integrimin.

b) Qeveria

Në vitin 2003, gjatë bisedimeve të ndërmjetësuarra ndërkombëtarisht në mes të Prishtinës dhe Beogradit për çështje teknike, të dyja qeveritë u pajtuan për krijimin e Grupit Punues për Persona të Zhdukur e që e mbajti takimin e parë në mars të vitit 2004. Përfaqësuesit e qeverisë të të dyja palëve ndërmjetësoheshin nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) dhe delegacioni i Kosovës ishte shoqëruar nga UNMIK-u. Edhe pse të dy qeveritë gojarisht pranuan përgjegjësinë për të vazhduar me punën e grupit punues, nuk u bë përparim i vërtetë sa i përket ndarjes së informacioneve të ndjeshme (shumica e takimeve ishin zhvilluar prapa dyerve të mbyllura)⁷⁶. Ndryshimet politike të këtij viti, (Shpallja e pavarësisë së Kosovës, shpërbërja e qeverisë së Serbisë dhe fushata zgjedhore e më pastajme në Serbi) kanë vonuar përparimin dhe qeveria e Kosovës nuk e ka caktuar përfaqësuesin e Grupit Punues të Prishtinës deri në prill 2008. Takimi i fundit është mbajtur në fund të prillit

⁷⁴ Intervistë personale me një zyrtar të lartë të EULEX-it, prill 2009.

⁷⁵ Procesverbal i sesionit të mbajtur më 3 mars 2008 të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione. Kuvendi i Kosovës. Prishtinë.

⁷⁶ Idriz Gashi, Intervistë. Mars 2008.

2008 në Beograd pas një pauze që nga dhjetori i vitit 2007⁷⁷. Pengesat e vazhdimet të këtij grupi përfshijnë refuzimin e Serbisë për të pranuar statusin e ri të Kosovës. Megjithatë, KNKK vazhdon të theksoj se natyra e këtij bashkëpunimi është humanitare dhe për këtë kjo duhet të vazhdohet⁷⁸.

Pas miratimit të Kushtetutës, Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) është themeluar, nën autoritetin e Presidentit të Kosovës⁷⁹. KKK-ja ka mandat ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës⁸⁰. Gjithashtu edhe Zyra për Komunitete, e themeluar pranë Zyrës së Kryeministrit (ZKM), ka rolin politik-bërës dhe koordinues përbrenda qeverisë për çështjet lidhur me komunitetet. Ndikimet praktike të këtyre dy organeve institucionale mbetet të shihen në një të ardhme të afërt.

c) Ministria për Komunitete dhe Kthim

Çështja e të kthyerve mbetet kritike për komunitetet pakicë në Kosovë. Deri më tani, nëntë vite pas luftës, më pak se 18,000 nga 60,000 – 220,000 serbë, romë dhe pakica tjera refugjatë dhe persona të zhvendosur janë kthyer⁸¹.

Përveç sigurisë, pengesat për të drejtën pronësore të vendbanimeve e vështirësojnë përparimin e shpejtë në këtë fushë. Pavarësisht ndarjes së fondeve nga qeveria për rindërtimin/ofrimin e strehimit për të kthyerit si dhe të përkrahjes së madhe financiare nga donatorët ndërkombëtarë për këtë çështje, qeveria ka dështuar në krijimin e lidhjes mes ndihmës për të kthyerit dhe ri integrimin dhe pajtimin.

d) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale themeloi Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës⁸² duke e ngarkuar me përgjegjësi për të rregulluar skemën e përfitimeve dhe zhdëmtimit për një numër të kategorive të viktimave të luftës dhe për pasardhësit të atyre që vdesin si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë. Aktualisht këto skema janë vënë në përdorim në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës. Në vitin 2006 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve e veteranëve të luftës së UÇK-së dhe familjarët e viktimave civile të luftës⁸³. Ligji përfshin grupet e viktimave si në vijim:

- Veteranët e UÇK-së dhe familjet e tyre
- Invalidët e UÇK-së
- Pengjet e luftës
- Ushtarët e zhdukur të UÇK-së

⁷⁷ Balkan Insight. Rifillojnë bisedimet për personat e zhdukur në Kosovë. 21 prill, 2008. Marrë nga: <http://balkaninsight.com/en/main/news/9531/>, <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/9677/>

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Neni 60 i Kushtetutës.

⁸⁰ Ibid. Neni 60.3.1.

⁸¹ Human Rights Watch. Kosovë: Ndërto shtet të ri në bazë të sundimit të ligjit. 15 shkurt 2008. Marrë nga: <http://www.hrw.org/english/docs/2008/02/15/Serbia18053.htm>

⁸² Faqja e internetit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale: <http://www.mpms-ks.org/index.php?id=1>

⁸³ Ligji Nr. 02/L-2 është miratuar prej Kuvendit të Kosovës në shkurt të vitit 2006 dhe është nënshkruar nga PSSP-ja në maj të vitit 2006. Megjithatë nuk mund të gjendet në Rregulloret e Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut.

- Viktimat civile
- Pengjet civile
- Personat e zhdukur civil

Kjo kornizë ligjore është i vetmi mekanizëm ligjor që merret dhe pranon çështjen e viktimave. Megjithatë, mungesa më e madhe e tij është “paaftësia e dallimit mes veteranëve dhe invalidëve të luftës në njërin anë dhe viktimave [civile] në anën tjetër”⁸⁴. Me futjen e të gjitha këtyre kategorive në një ‘paketë’, ligji i shpall martir të gjithë viktimat, përfshirë këtu edhe civilët dhe personat e zhdukur⁸⁵. Sipas Bashkimit të Asociacioneve të Familjarëve të zhdukur, ka qenë e papranueshme për familjet e të zhdukurve për të pasur vetëm një ligj që do të mundahej ta zgjidhte të gjithë problemin duke e arsyetuar “çështja është shumë e ndjeshme dhe kërkon ligj të veçantë”⁸⁶.

e) Gjykatat e Kosovës

Misioni i KB-ve në largim do t’i dorëzojë dosjet dhe dokumentacionin e rasteve ‘të ndjeshme’ të pazgjidhura EULEX-it dhe sistemit të drejtësisë të Kosovës. Qeveria e Kosovës ka shpallur Misionin e BE-së ‘dorë ndihmëse që do të ndihmojë të lehtësojë ngarkesën’ që e ka sistemi i drejtësisë i Kosovës. Kjo mund të kuptohet si mungesë e nismës për zgjidhjen e çështjeve të saja nga vetë populli i Kosovës. Megjithatë, kjo mund të jetë

Shumica mendojnë që ndjekja penale dhe procedurat janë mekanizmat më të rëndësishëm për t’u arritur drejtësia.

rezultati negativ i traditës së gjatë prej një dekade e të qenit të paaftë dhe të pafuqishëm siç është parë nga ‘ekspertët ndërkombëtarë’ për të zgjidhur problemet e shoqërisë. Gjatë këtyre viteve është trashëguar një hutim në gjyqësinë vendore, në mes të zgjedhjeve të tyre e të qenit të guximtarë për t’u marrë me rastet me rrezikshmëri të lartë apo t’i shërbejnë sistemit ekzistues ku

misionet e KB-ve apo BE-së do të ishin ata që i marrin vendimet apo të largohen pa pasur përgjegjësi nëse nuk do të merrnin vendimet e duhura.

Edhe pse eksperti i njohur i drejtësisë tranzicionale, Pablo De Greiff, mendon në drejtësinë penale ‘më shumë si luftë kundër kryerësve të krimit sesa përpjekje e bërë në emër të viktimave’ për grupet etnike të Kosovës mendimi është paksa më ndryshe⁸⁷. Për shumë viktima të etniteteve të ndryshme të Kosovës ndjekja penale dhe dënimi i kriminelëve, si në Dhomën e Veçantë për Krime Luftë në Gjykatën e Qarkut në Beograd apo në Gjykatën e Qarkut në Kosovë nga një prokuror ndërkombëtar, ofron një ndjenjë të besimit dhe lehtësimi⁸⁸. Megjithatë, mosbesimi i grupeve kryesore etnike në Kosovë për gjykatat e Kosovës dhe Serbisë paraqesin pamje tjetër. Vetëm 9% të serbëve të Kosovës i besojnë gjykatave të Kosovës dhe vetëm 3% të shqiptarëve të Kosovës besojnë që gjykimet për krime lufte të mbajtura në gjykatën e qarkut të Beogradit janë sipas standardeve ndërkombëtare⁸⁹. Të dhënat tregojnë që shumica mendojnë që ndjekja penale dhe procedurat janë mekanizmat më të rëndësishëm për t’u arritur drejtësia⁹⁰. Shumica e popullatës së

⁸⁴ Raporti i UNDP-së, op.cit., f. 29.

⁸⁵ Grupi i Fokusit. Mars 2008.

⁸⁶ Haki Kasumi. Intervistë. 22 prill 2008.

⁸⁷ DeGreiff, Pablo. Doracak për zhdëmtimet

⁸⁸ Bekim Blakaj Intervistë. Qendra e së Drejtës Humanitare – Prishtinë.

⁸⁹ Raport i UNDP-së, f. 21

⁹⁰ Ibid.

Kosovës, saktësisht 90%, gjithashtu mendojnë që dënimi i të gjithë kryerësve të krimeve të luftës dhe shkelësve të të drejtave të njeriut në Kosovë është element thelbësor i drejtësisë⁹¹. Mirëpo, asociacionet që i përfaqësojnë familjarët e të zhdukurve e thonë të kundërtën. Sipas tyre, në të gjitha rastet gjykimet duhet të mbahen në vendin ku është kryer krimi dhe “gjykimet në Beograd janë të papranueshme”⁹².

Në rastin më të ri penal ndëretnik në Prishtinë, për trazirat e marsit procedura ligjore ka përfunduar në janar të vitit 2008, dy vite pasi ato ishin nisur nga akuzat e ngritura nga një prokuror ndërkombëtar në vitin 2004. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, udhëhequr nga prokurorë ndërkombëtarë, ka dënuar 5 shqiptarë të Kosovës me gjithsejtë 23 vite burgim për prishje të sigurisë, nxitje të urrejtjes dhe trazira. Po ashtu nga të gjithë të akuzuarit ishin kërkuar dëmshpërblime në shumë prej 50,000 EUR për t'i rindërtuar pronat e viktimave⁹³. Gjykatat vendore të qarkut dhe komunale po ashtu ngritën akuza penale, mbajtën gjykime dhe dënuan 145 njerëz për krime të ndryshme në trazirat e marsit.

Ndjekja penale dhe dënimet e lidhura me trazirat e marsit po ashtu i përkasin rasteve më të shumta prej të cilave nuk u diskutuan publikisht apo u debatuan edhe pse do të mund të paraqisnin një arsye për diskutim për sferën e drejtësisë tranzicionale.

f) Shoqëria Civile dhe Mediat

Nismat tepër të rralla në sferën që ka të bëjë me drejtësinë tranzicionale mund të gjenden nën petkun e shoqërisë civile. Sipas shumë analistëve, Kosovës i mungon origjinaliteti vendor i aktiviteteve për të drejtat e njeriut me guxim dhe mjaftueshëm për tu marrë me detyrat që kanë të bëjnë me të kaluarën.

Projektet e gjetjes të së vërtetës dhe mbledhjes së të dhënave për viktimat më së shumti janë të pavërejtura dhe kanë mbështetje të ulët nga qeveria⁹⁴.

Projektet e gjetjes të së vërtetës dhe mbledhjes së të dhënave për viktimat më së shumti janë të pavërejtura dhe kanë mbështetje të ulët nga qeveria

Debatet publike në çështjet jashtëzakonisht të ndjeshme politike/gjyqësore të kriminelëve filluan të diskutohen në media në prill të vitit 2009 dhe përgjithësisht u mirëpritën nga publiku. Këto debate filluan me një artikull të botuar nga BBC dhe Balkan Insight lidhur me kampet e dyshuara dhe burgjet ilegale të cilat i kishte drejtuar UÇK-ja në pjesën veriore të Shqipërisë gjatë konfliktit të vitit 1998-99. ky raport i cili u ribotua dhe u komentua në një masë të madhe u përcoll nga një debat i nxehtë në Kosovë, Shqipëri dhe Serbi. Sipas të gjeturave të raportit, UÇK, me dijeni të komandantëve të sajë të lartë, kishte drejtuar burgje ku mbaheshin, torturoheshin dhe përfundimisht ekzekutoheshin⁹⁵ kryesisht Shqiptarët e akuzuar për bashkëpunim me regjimin e Millosheviqit, por edhe civilë Romë dhe Serbë. Këto debate e filluan diskutimin lidhur me të drejtën tranzicionale edhe midis Shqiptarëve por edhe midis Shqiptarëve dhe Serbëve.

Projektet për mbledhjen e informatave për viktimat dhe për ndihmën juridike dhe përfaqësimin e viktimave dhe familjarët e tyre në procedura gjyqësore bëhen nga degët në

⁹¹ Raport i UNDP-së, f. 21

⁹² Haki Kasumi. Intervistë. 22 prill 2008.

⁹³ Koha Ditore, 26.1.2008, f. 9.

⁹⁴ Shembull për këtë është projekti i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut për monografinë e viktimave të luftës në Kosovë që përfshin të gjitha bashkësitë e Kosovës.

⁹⁵ Ekskluzive: UÇK-ja ka pasur kampe torturash në Shqipëri, 9 prill 2009, Gjithashtu shih <http://balkaninsight.com/en/main/news/18047/>

Prishtinë të organizatave të Beogradit⁹⁶. Rastet e gjykimeve të shkelësve të të drejtave të njeriut gjatë luftës, të mbajtura në Kosovë, nuk janë përdorur për të mundësuar forma më të mëdha të debatit në mes të intelektualëve në shoqëri si dhe të të prekurve (viktimat).

4.2. Dokumentet kryesore

Në Kosovë i jepet vëmendje e konsiderueshme përpjekjeve legjislative. Ndonëse vëmendja e tillë shpesh mbërrin vetëm deri te miratimi i tyre, rëndësia e të pasurit dokumente të mira mund shumë vështirë të mbivlerësohet. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ofron disa udhëzime për tu përballur me krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Propozimi veçanërisht e obligon Kosovën që të “respektojë në tërësi procesin e pajtimit në mes të të gjitha komuniteteve të saj dhe pjesëtarëve të tyre”⁹⁷. Si i tillë, ky dokument ia lë në duar institucioneve të Kosovës të zhvillojnë strategji se si do të merren me pajtimin dhe aspektet tjera të padrejtësive të së kaluarës. Sipas dokumentit, Kosova “do të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, me ndjeshmëri gjinore, për t’u ballafaquar me të kaluarën e saj, e cila do të përfshijë një varg të gjerë nismash tranzicionale të drejtësisë”⁹⁸. Veç këtij udhëzimi që Propozimi i jep institucioneve të Kosovës, tërthorazi përkujdeset për segmente të caktuara të drejtësisë tranzicionale, kryesisht përmes nxitjes së integritetit, legjitimitetit dhe përgjegjësisë të institucioneve.

Një tjetër dokument kyç është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Sipas dispozitave të saj për “Përgjegjësitë e shtetit”, kushtetuta bën thirrje të “promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve”⁹⁹. Kjo është i vetmi rast ku kushtetuta i drejtohet çështjes së pajtimit dhe bisedimeve ndëretnike. Sipas shumë ekspertëve të shoqërisë civile për këto çështje, kjo është shumë pak¹⁰⁰. Me aq shumë probleme serioze së pari në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës dhe me mungesën e plotë të bisedimeve në mes të bashkësive të ndryshme që jetojnë në Kosovë, shoqëria duhet të ketë një udhëheqësi më të fuqishme për ti ngritur këto çështje me qëllim të materializimit të dispozitave të Kushtetutës dhe për të arritur pajtimin midis komuniteteve.

4.3. Mekanizmat e luftimit të padrejtësive dhe keqpërdoruesve

Në ish vendet e Jugosllavisë janë përdorur mekanizma të ndryshëm ku përfshihen, kompensimi, dëmshpërblimi, vendosja për fatin e të zhdukurve dhe hapja e përkujtimeve, ndërsa rikthimi i të drejtës në pronë si dhe dëmshpërblimi kryesisht janë ofruar për popullatën shumicë (“fitimtarët” e luftës)¹⁰¹.

Gjetja e së vërtetës – Perceptimi i shqiptarëve të Kosovës dhe i serbëve të Kosovës për burimet ‘që ofrojnë’ të vërtetën për krimet e luftës të kryera gjatë luftës në Kosovë

⁹⁶ Dy nga këto organizata që punojnë për bisedime ndër-etnike dhe që përfshihen në Qendra e së Drejtës Humanitare dhe Iniciativa e të Rinjve. Të dyja nga I

⁹⁷ Neni 2.5 i Propozimit të Ahtisarit.

⁹⁸ Ibid.

⁹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 58.2 ‘Përgjegjësitë e shtetit’ www.kshva.gov.net/pm/LinkClick.aspx?fileticket=VFtVVBysfWI%3d&tabid=36

¹⁰⁰ Grup i Fokusit . Mars 2008

¹⁰¹ “Drejtësia Tranzicionale në vendet e ish-Jugosllavisë: Raport për 2006”. Qendra e së Drejtës Humanitare; Dokumente; Qendra për Hulumtime dhe Dokumentim-Sarajevë, f. 7.

Mungon “përkrahja e mjaftueshme nga strukturat politike për ndjekjen penale të të dyshuarve për krime lufte ...si dhe masa jo adekuate për mbrojtjen e viktimave ”

ndryshojnë në një masë të madhe. Gjersa shqiptarët e Kosovës i konsiderojnë procedurat gjyqësore të gjykimeve të krimeve të luftës burimet më të besueshme për të provuar të vërtetën, serbët e Kosovës nuk pajtohen që gjykimet për krime të luftës mund të ndihmojnë në gjetjen e të vërtetës¹⁰². Ekziston mendimi në mes të dy popujve, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi se e vërteta gjendet në anën tjetër të kufirit. Nganjëherë, pjesë të vërtetës së plotë fshihen në mes të palëve që kanë qenë drejtpërdrejt të përfshira në konflikt¹⁰³.

Ndjekja penale e krimeve të luftës, si metodë e gjetjes së vërtetës, janë përdorur në vendet e ish Jugosllavisë, përfshirë Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë dhe Serbinë, përmes zyrave të veçanta të prokurorisë si dhe dhomave të veçanta për tu marrë vetëm me rastet e krimeve serioze të luftës¹⁰⁴. Përveç përmirësimit të procedurave gjyqësore dhe gjykimeve të krimeve të luftës kjo gjithashtu përmirësoi besimin e qytetarëve në mekanizmat gjyqësorë. Megjithatë, që të tri vendet kanë pasur “përkrahje të pa mjaftueshme nga strukturat politike për ndjekjen penale të të dyshuarve për krime lufte pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre, si dhe masa jo adekuate për mbrojtjen e viktimave”¹⁰⁵. Probleme të njëjta gjithashtu ekzistojnë edhe në Kosovë.

Çështje tjetër është edhe prania e vazhdueshme e misionit ndërkombëtar në Kosovë. Ndonëse krijimi i Gjykatës për Krime Luftë dhe Etnike në Kosovë nuk ka funksionuar menjëherë pas luftës, modeli mund të merret parasysh përsëri në kushtet ekzistuese. Megjithatë, është me rëndësi parësore që edhe nëse funksionon me grup të përzier të gjykatësve dhe prokurorëve vendorë dhe ndërkombëtarë pavarësia e saj nga qeveria e Kosovës dhe pushteti ekzekutiv i misionit të BE-së duhet të sigurohet.

Personat e zhdukur – Ndjenja e përfundimit që mund të mbizotëroj për shumë qytetarë të Kosovës për shkak të ndryshimeve politike nuk zbatohen për familjarët e viktimave të zhdukura. Për ta nuk ka përfundim derisa njoftimi për fatin e tyre nuk zbulohet si dhe nuk gjendet vendndodhja e tyre¹⁰⁶. Dhimbja e tyre nuk njihet ndarje etnike dhe kjo pranohet deri në një masë nga shoqëria që përkrah zgjidhjen e fatit të të zhdukurve pa marrë parasysh prejardhjen etnike të tyre¹⁰⁷. KNKK-ja i ndihmon institucionet vendore në kërkimin e tyre për informacione dhe të vërtetën sa i përket personave të zhdukur dhe rregullisht publikon dhe shpërndan raporte me lista të personave të panjohur ne përpjekje për të gjetur informacione¹⁰⁸. Sipas Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Zhdukur, përveç arsyeve që Grupi Punues i Prishtinës për Persona të Zhdukur nuk përgatitet në mënyrë të duhur para ballafaqimit me Grupin Punues të Beogradit, zgjidhja e statusit të Kosovës e ka ndërlikuar edhe më tej çështjen e personave të zhdukur në relacion me Beogradin¹⁰⁹. Sipas të njëjtës, shqiptarët e Kosovës po e harrojnë dhimbjen e tyre e me këtë nuk po luftojnë në masë të mjaftueshme për të gjetur të vërtetën¹¹⁰. Në këtë temë,

¹⁰² Perceptimi i Publikut mbi drejtësinë kalimtare i UNDP-së: Raport mendimin për drejtësinë kalimtare analizë e mbajtur gjatë prillit-majit të vitit 2007 në Kosovë.

¹⁰³ Intervistë. Mars 2008.

¹⁰⁴ “Drejtësia kalimtare në vendet e ish-Jugosllavisë: Raporti për vitin 2006”. Qendra për të Drejtën Humanitare; Dokumenta; Qendra për hulumtim dhe dokumentim-Sarajevë, f. 6.

¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ Dita ndërkombëtare e shënuar e të Zhdukurve e KB-së është 31 gushti, ndërsa Kosova e shënon ditën e vet të të zhdukurve më 27 prill.

¹⁰⁷ Raporti i UNDP-së, f.7.

¹⁰⁸ Intervistë me Melinda Bytyqin dhe Idriz Gashin. KNKK-Kosovë. Mars 2008.

¹⁰⁹ Haki Kasumi. Intervistë. 22 prill 2008.

¹¹⁰ Ibid.

aktivistë të shumtë të të drejtave të njeriut pohojnë se “dhimbja e nënës shqiptare të Kosovës është e njëjtë me atë të nënës serbe të Kosovës”¹¹¹.

Njohja e statusit të viktimave dhe zhdëmtimet – Drejtësia tranzicionale në thelb përqendrohet te viktimat. Masat e saj përqendrohen drejt njohjes zyrtare të lëndimit që viktimat kanë përjetuar dhe të ndihmojnë në procesin e shërimit përmes gjetjes së vërtetës dhe dhënies së përgjegjesisë të kryerësve të saj. Megjithatë në Kosovë, masat gjyqësore si dhe mekanizmat dëmshpërblyese janë lënë pas dore nga administrata ndërkombëtare, mandati i së cilës shihej kryesisht i përqendruar në ruajtjen e sigurisë¹¹². Ata të cilët më së shumti kanë vuajtur në shoqërinë kosovare janë viktimat e padrejtësive, ku të drejtat për të pasur informacione për familjarët e tyre të zhdukur, për tu pranuar si viktimat nga institucionet qeverisëse ose të pranojnë dëmshpërblim për humbjen e tyre ende nuk janë përmbushur.

Sa i përket kompensimit, procesi duhet të bëhet në baza individuale për dëmtime fizike dhe materiale¹¹³. Në Kosovë, një numër relativisht i vogël i qytetarëve të Kosovës duket t'i përkrahin masat jo-materiale për të lehtësuar vuajtjet e viktimave, përfshirë këtu edhe njohjen e statusin e viktimës si dhe programet rehabilituese dhe ri-socializuese¹¹⁴. Në anën tjetër zhdëmtimi material përkrahet fuqishëm nga popullata si mekanizëm që do të duhej të zbatohet për të gjitha viktimat pa marrë parasysh prejardhjen etnike¹¹⁵. Megjithatë, do të jetë shumë vështirë që të zbatohet kompensimi për shkak se qeveria e Serbisë nuk është as përafërsisht e gatshme që të pranojë përgjegjësinë për krimet dhe shkatërrimet të cilat ishin kryer nga Beogradi gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë.

Memorialët – Shumica e infrastrukturës së shkatërruar nga lufta është rindërtuar me asistencën e bashkësisë ndërkombëtare dhe vetë shqiptarëve. Sa i përket memorialëve për nderimin e viktimave, në të shumtën e rasteve janë ndërtuar monumente në shkallë të vogël për të nderuar ushtarët e UÇK-së. Shumë qyteza dhe qytete kanë vende të vogla të memorialëve për të nderuar viktimat siç është rasti në Gjakovë që së fundi e zbuloi memorialin të quajtur “Muri i Dhimbjes” me emrat e të gjithë personave të vdekur dhe të zhdukur¹¹⁶. Deri më tani, nuk ka pasur asnjë nismë të rëndësishme për të nderuar të gjitha viktimat e luftës dhe të viteve të kaluara. Në mes të qytetarëve, vetëm 15% të popullatës besojnë që këto përkujtime mund të ndihmojnë në lehtësimin e vuajtjeve të viktimave¹¹⁷. Megjithatë, deri më tani nuk mund të ketë një memorial që do të pranohej nga “ana tjetër”, duke lënë kështu shumë hapësirë në kërkim të përkujtimeve si një mjet kalimtar.

Reforma e sektorit të sigurisë – Në këtë fushë rezultatet janë më lehtësuese. Megjithatë, shpallja e pavarësisë mund të krijoj gjendje për një impuls të ri në këtë sektor. Nuk janë vendosur asnjë lloj i procedurave të korrigjimit si nga ana e policisë po ashtu edhe nga ana e

¹¹¹ Grup i Fokusit. Mars 2008.

¹¹² Grup i Fokusit. Mars 2008.

¹¹³ Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve më 1997 cituar në Thiesse, Gunnar. Përkrahja e drejtësisë, Bashkëjetesa dhe pajtimi pas konfliktit të armatosur: Strategjitë e të përballurit me të kaluarën. Doracak i Berghof-it 2004. Marrë nga: <http://berghof-handbook.net>

¹¹⁴ 37 % shqiptarëve të Kosovës dhe 39 % të serbëve të Kosovës i konsiderojnë programet rehabilituese më të qëlluarat ndërsa 29% shqiptarëve të Kosovës dhe 27% të serbëve të Kosovës konsiderojnë njohjen e statusit të viktimave si të përshtatshëm po ashtu. Ibid.

¹¹⁵ Shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës e përkrahin zhdëmtimin material me 80% përkatësisht 87%. Perceptimi i Publikut për Drejtësinë Kalimtare i UNDP-së.

¹¹⁶ Koha Ditore, ‘Kujtohen të pagjeturit’. 27 prill 2008.

¹¹⁷ Raport i UNDP-së, op.cit., f.30.

gjyqtarëve dhe prokurorëve¹¹⁸. Mungesa e procesit të korrigjimit vështirëson besimin në institucionet e sigurisë, që është veçori e shoqërisë post-konfliktuale¹¹⁹. Vërtetë institucionet e sigurisë ende ju duhet të forcojnë sistemet e tyre të kontrollit të brendshëm dhe të rrisin besimin që qytetarët kanë për to¹²⁰.

Para shpalljes së pavarësisë sektori i sigurisë ishte kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut dhe NATO-s. Çdo përfshirje vendore, përveç mbikëqyrjes ishte pothuajse jo ekzistente. Në vitin 2005, është bërë një hap domethënës. PSSP-ja i atëhershëm Soren Jesen Petersen themeloi sektorin e rishikimit të sigurisë së brendshme në mënyrë që të rrisë zotërimin vendor të sektorit të sigurisë. Një aspekt pozitiv i këtij rishikimi ishte këshillimi gjithëpërfshirës i popullatës në Kosovë. Kjo lejoi të merreshin parasysh sfera të tëra të kërcënimeve dhe që sektori i sigurisë të projektohej bazuar në nevojat e republikës. Për më tepër, shpallja e pavarësisë çoi në miratimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Ky dokument themelor ligjor si dhe plani i Ahtisarit mundësuan themelimin e strukturave të sigurisë të bazuara në të drejtat e njeriut¹²¹.

Në këtë fushë të kontrollit civil të institucioneve të sigurisë, përparim filloi ngadalë që nga viti 2005 së pari e pastaj në një shkallë më të gjerë pas shkurtit të vitit 2008. Komisioni i Kuvendit për Siguri i themeluar në vitin 2005 ndihmoi në fillimet e para të mbikëqyrjes parlamentare në çështjet e sigurisë. Korniza e re kushtetuese si dhe ajo ligjore që burojnë nga deklaratat e pavarësisë mundësojnë rol më të plotë për komisionet e Kuvendit në mbikëqyrjen e institucioneve të sigurisë.

5. Përfundime dhe rekomandime

Shumë vende të dala nga konflikti dhe periudha kalimtare nga lufta në paqe kërkojnë momente historike të shndërrimit politik për të pranuar ndryshimet dhe vlerat e reja. “Kur një shoqëri ‘e kthen faqen tjetër’ apo ‘nisë fillim të ri’, mekanizmat e drejtësisë tranzicionale mund ta ndihmojnë këtë proces”¹²². Për Kosovën, ekzistojnë dy fillime - qershori i vitit 1999 dhe Shkurti i vitit 2008. Megjithatë, shoqëria po përjeton periudhë të stërzgjatur të kushteve kaotike derisa po krijohen infrastruktura të reja të arsimit, drejtësisë, sigurisë dhe qeverisë¹²³. Shpallja e pavarësisë është momenti tjetër historik për Kosovën. Është po ashtu rasti i saj

¹¹⁸ Shih udhëzimin administrativ të UNMIK-ut Nr. 2006/18 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/25 për Kornizën rregulluese për sistemin e drejtësisë në Kosovë. Parashihet që duhet të vendosen procedura të vetme dhe gjithëpërfshirëse të procedurave të verifikimit për ri-emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, procedura nuk përfshin hetimin të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut në të kaluarën.

¹¹⁹ GJNKJ, *Sfidimi i pasojave të mos-ndësbkueshmërisë*, 2006/2007, f. 24.

¹²⁰ Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) vuajnë nga mungesa e besimit nga pakicat.

¹²⁰ Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) duket se ka një nivel të kënaqshëm të besimit nga publiku, por prapë se prapë konsiderohet si i politizuar dhe i korrumpuar¹²⁰. Mosbesimi i publikut për institucionet gjyqësore është problematik: një analizë e kryer më 2006 tregoi që ata që e konsiderojnë gjyqësorin se është ‘jo i drejtë’ apo ‘shumë jo i drejtë’ janë gati dyfishi i atyre që kanë besim në sistem. Shih UNDP, *Rishikimi I sektorit të brendshëm të sigurisë në Kosovë*, 2006, f. XVIII dhe f. 67.

¹²¹ Jo vetëm që institucionet e sigurisë duhet të “veprojnë në transparencë të plotë standardet e pranuar ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut” por duhet të reflektojnë edhe shumëllojshmërinë etnike të Kosovës. Shih kushtetuta e Republikës së Kosovës nenet 125, 126, 127 dhe 129. Shih po ashtu shtojcën VII të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

¹²² Enciklopedia e Gjenocidit dhe krimeve kundër njerëzimit (Macmillan Reference SHBA, 2004), vol. 3, f. 1045-1047. Marrë nga <http://www.ictj.org>.

¹²³ Grup i Fokusit. Mars 2008.

historik për të bërë përpjekje të përbashkëta për të punuar drejt korigjimit të shumë padrejtësive të bëra përpara, gjatë dha pas luftës.

Megjithatë, duke marrë parasysh mungesën e bisedimeve të hapura për të kaluarën, mbyllja e kapitullit të fundit nuk është i pranueshëm për shumë kë. Çështja e personave të zhdukur është ende barrë e rëndë për familjarët që ndihen të braktisur nga institucionet në kërkimin e tyre për të vërtetën. Kah mesi i vitit 2007, shumica e popullsisë konsideronte që zgjidhja e fatit të personave të zhdukur është kusht për arritjen e drejtësisë¹²⁴. Kjo nuk ka ndryshuar një vit më vonë.

Kosova ende është duke i ndërtuar institucionet e saja dhe për të forcuar demokracinë në të gjitha nivelet duhet ta përdorë ballafaqimin me të kaluarën si “instrument në promovimin e normave të reja sociale në fushat e drejtësisë, qeverisjes së mirë dhe të drejtave të njeriut”¹²⁵. Pranimi i faktit se ekziston nevojë emergjente e qytetarëve për informacion, të vërtetën dhe bisedime të hapura do të paraqiste një hap të madh për shoqërinë e Kosovës.

Qeveria e Kosovës duhet të njoh perceptimin nga publiku të formave të ndryshme të drejtësisë tranzicionale dhe t'i merr ato parasysh për të zhvilluar strategji që do të kuptoheshin mirë dhe të pranoheshin nga popullata.

Koha, konsiderohet si parakusht për të punuar me një shoqëri që zgjohet nga një traumë e goditur gjatë. Në rastin e Kosovës, kjo nuk duhet të konsiderohet si arsyetim për të fshehur çështjet e së kaluarës së afërt të cilat kërkojnë të bëhet debat i mëtejshëm. Shumë shqetësime të pazgjidhura për përgjegjësinë dhe veçanërisht për gjetjen e së vërtetës do të vazhdojnë të ngarkojnë qytetarin dhe marrëdhëniet ndëretnike, nëse atyre nuk i jepet një vëmendje pro aktive.

Në iniciimin e programit gjithëpërfshirës të veprimeve për t'u përballuar me të kaluarën, Kosova është në pozitë të veçantë për të vendosur një shembull për gjithë rajonin. Në mesin e masave që do të mund të ndërmerreshin në të ardhmen e afërt, disa prej tyre janë të radhitura si më poshtë:

1. EULEX-i dhe sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet ta konsiderojë si parësore krimet e luftës dhe ato ndëretnike dhe viktimat e armiqësive ndër-shqiptare gjatë periudhës 1998-1999. Për besueshmërinë e këtij procesi gjyqësor nevojitet transparenca e plotë me qëllim të sigurimit të besimit publik.
2. Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë një Gjykatë Speciale për Krime të luftës me qëllim të adresimit efikas të krimeve të kryera kundër civilëve përpara, gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1998-99.
3. Debati publik i cili ka filluar lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë duhet të inkurajohen nga qeveria e Kosovës dhe prania ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të një klime të duhur publike për një proces të suksesshëm të drejtësisë tranzicionale në Kosovë.
4. Zgjidhja e çështjes së të zhdukurve të gjitha etnive në Kosovë duhet të jetë prioriteti numër një i Qeverisë dhe Kuvendit.
5. Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë duhet të zotohen për një dialog të depolitizuar për zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë.

¹²⁴ Kjo shumicë ishte përgjigja e shqiptarëve të Kosovës, serbëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të pakicave tjera gjithashtu. Përkrashja nga të gjitha bashkësitë arrin në 96%. Ibid.

¹²⁵ Bleeker, op.cit., f. 3.

6. Të gjitha masat e tilla të së drejtës tranzicionale të cilat do të iniciohen duhet të respektojnë me përpikëri nevojat, pritjet dhe brengat e të gjitha komuniteteve në Kosovë.
7. Drejtësia e suksesshme tranzicionale është një parakusht për pajtim në Kosovë. Megjithatë, pajtimi gjithashtu ka edhe dimensionin politik. Një pajtim i plotë midis komuniteteve të shqiptarëve dhe serbëve do të arrihet vetëm atëherë kur Serbia të pranojë përgjegjësinë e plotë për krimet e kryera nga institucionet e saja dhe të zbatohet drejtësia për viktimat nga të gjitha komunitetet në Kosovë.